

Përkthyesi Joachim Röhm, ekskluziv i veprave të Kadaresë me afro pesëdhjetë romane, novela, tregime, ese, përmbledhje poezish në tregun gjermanishtfolës të librit, në një rrëfim për jetën, përkthimin dhe botën shqiptare, për librat e Kadaresë, deri në librin e fundit që pritet të dalë këtë muaj: një përmbledhje e teksteve autobiografike me lidhje me Gjirokastrën, duke përfshirë edhe romanin "Kukulla".

JOACHIM RÖHM: Pa një karrierë solide në vendin tënd s'mund "të pushtosh botën letrare" në Europë apo Amerikë

**ÇMIMI NOBEL
IU DHA NJË
MBËSHTETËSI TË
MILLOSHEVIQIT**

nga **MEHMET KRAJA**

**PEIZAZHI –
RRËFIMTARI
I RREZIKUAR**

nga **Virion Graçi**

**E NJERËZISHMJA
NË POETIKËN E
SIMON VRUSHOS**

nga **Namir Lapardhaja**

**■ UJI, E GJITHË
PESHA E TIJ**

tregim nga

Roxane Gay




BIBLIOTEKË

**■ FUNDI
I TË FUNDMES
SHPRESË**

tregim nga **Safet Sadiku**

Portreti nga Ina Lajthia



Numri i përkthyesve nga shqipja në gjermanishte nuk është kaq i vogël, siç thoni ju. Mund të jetë që disa kanë botuar pak, disa asgjë. Por janë, ekzistojnë. Nga ana tjetër, ka një rezervuar gati të pashfrytëzuar përkthyesish: të rinjtë shqiptarë që kanë ardhur ose kanë lindur në botën gjermanishtfolëse dhe zotërojnë të dyja gjuhët mirë. Në Gracin e Austrisë dhe në ndonjë shkollë tjetër të lartë përgatiten përkthyes të gjuhës shqipe. Besoj se këtu kemi të bëjmë me një paradigmë aq të dyshimtë sa edhe të përhapur midis krijuesve shqiptarë: që mossauesi relativ i letërsisë bashkëkohore shqiptare nëpër botë vjen nga mungesa ose dembelizmi i përkthyesve. Them "mossaues relativ", sepse nuk ka qas shumë vende në këtë planet që mund të krenohen me një autor të famës botërore siç është Kadareja. Përveç kësaj, si matet ky "mossaues"? Sa shkrimtarë të një vendi mund të pretendojnë të botohen jashtë? Sa shkrimtarë të një vendi duhet të jenë të pranishëm në tregjet e huaja të librave për të thënë se vendi i tyre është i përfaqësuar sa duhet?

**ÇFARË KA SHKRUAR
KADARE
PËR NOBELISTIN
PETER HANDKE
NJËZET VJET MË PARË**



DRITA DHE ERRËSIRA E ÇMIMIT NOBEL 2019


nga **Rafia Zakaria (CNN)**

**2018: Olga
Tokarczuk**

**2019: Peter
Handke**



ÇFARË KA SHKRUAR KADARE PËR PETER HANDKEN NJËZET VJET MË PARË NË DITARIN E TIJ PËR KOSOVËN “RA KY MORT E U PAMË”



20 prill 1999

Televizioni austriak më kërkon një mendim për qëndrimin e Peter Handkes. Në Austri dhe në Gjermani ka fushatë të ashpër kundër tij. Ai qëndrim, ç'është e vërteta, më shumë se zemërim, më ka shkaktuar brengë. Siç ndodh me njerëzit që i njeh. Siç ndodh me sjelljet që ndryjnë brenda një mister.

Shkrimtari më i njohur i Austrisë. Me nënë sllovene. Frankofon. Prej vitesh, duke qenë këshilltar pranë shtëpisë botuese austriake “Residennz Verlag”, është ai që ka propozuar librat e mi për përkthim.


E kam njohur para ca vitesh në Paris. Ambasadoja e Austrisë në Francë na ftoi për darkë të dyve, bashkë me gratë. Gruaja e tij franceze është e admirueshme.

Nuk e gjej dot ç'grerëz e ka pickuar. Gjithë ai tërbim kundër shkrimtarëve boshnjakë, gjithë ai zell për të mbrojtur krimet serbe në Bosnjë e pastaj në Kosovë.

Një shkrimtar kroat përpiqet ta shpjegojë me zanafillë frojdiste. Nuk më besohet.

Ndërkaq, nga darka në ambasadën austriake më kujtohet një frazë e tij. Një frazë disi e veçantë, e thënë me njëfarë pikëllimi: “nuk jam më i njohur si më parë”.

A mund të jetë atje ana e së keqes? Ndoshta, pse jo.



Përkthyesi Joachim Röhm, ekskluziv i veprave të Kadaresë me afro pesëdhjetë romane, novela, tregime, ese, përmbledhje poezish në tregun gjermanishtfolës të librit, në një rrëfim për jetën, përkthimin dhe botën shqiptare, për librat e Kadaresë, deri në librin e fundit që pritet të dalë këtë muaj: një përmbledhje e teksteve autobiografike me lidhje me Gjirakastrën, duke përfshirë edhe romanin "Kukulla". "Me sa duket, për publikun letrar në Gjermani, Austri dhe Zvicër jam shkruarë në njëfarë mënyre me autorin, si zëri i tij gjerman", - thotë Röhm në këtë udhëtim të gjatë të përkthyesit me shkrimtarin, receptimit të veprës së tij në gjuhë gjermane

JOACHIM RÖHM

PA NJË KARRIERË SOLIDE NË VENDIN TËND S'MUND TË PËRPIQESH "TË PUSHTOSH BOTËN LETRARE" NË EUROPË APO AMERIKË

Intervistoi: Violeta Murati

Ju jeni një përkthyes i rrallë i shqipes, të cilën e njihni mirë, në gjuhën gjermane. Një shqiptardashës i mirë po ashtu, a ndiheni disi i harruar në këto kohë?

Numri i përkthyesve nga shqipja në gjermanisht nuk është kaq i vogël, siç thoni ju. Mund të jetë që disa kanë botuar pak, disa asgjë. Por janë, ekzistojnë. Nga ana tjetër, ka një rezervuar gati të pashfrytëzuar përkthyesish: të rinjtë shqiptarë që kanë ardhur ose kanë lindur në botën gjermanishtfolëse dhe zotërojnë të dyja gjuhët mirë. Në Gracin e Austrisë dhe në ndonjë shkollë tjetër të lartë përgatiten përkthyes të gjuhës shqipe. Besoj se këtu kemi të bëjmë me një paradigme aq të dyshimtë sa edhe të përhapur midis krijuesve shqiptarë: që moksuesi relativ i letërsisë bashkëkohore shqiptare nëpër botë vjen nga mungesa ose dembelizmi i përkthyesve. Them "moksues relativ", sepse nuk ka kaq shumë vende në këtë planet që mund të krenohen me një autor të famës botërore siç është Kadareja. Përveç kësaj, si matet ky "moksues"? Sa shkrimtarë të një vendi mund të pretendojnë të botohen jashtë? Sa shkrimtarë të një vendi duhet të jenë të pranishëm në tregjet e huaja të librave për të thënë se vendi i tyre është i përfaqësuar sa duhet? Unë do të thosha se në krahasim me shumë vende ose shtete të tjera, mjaft më të mëdha, numri i autorëve shqiptarë që janë botuar jashtë, edhe në gjermanisht, nuk është aq i vogël. Por kryesorja është: në qoftë se ka, le të themi, një përhapje të kufizuar të letërsisë shqiptare nëpër botë, mund të ketë edhe arsye të jashtme. Por arsyet kryesore janë të brendshme. Dhe në çdo rast duhet thënë: fajti nuk u bie përkthyesve të shkretë. Besoj se do të kemi mundësi të hyjmë më thellë në këtë temë. A jam disi i harruar? Prapë një paradigme shqiptare, ndoshta. Sikur çdo gjë në botë të matet me metrin shqiptar. Në Shqipëri, nuk di sa i harruar jam. Ndoshta shumë. S'prish punë. Kur t'i afroshesh çështjes me objektivitet, ka gjasa që unë me punën time dyzetvjeçare në botën letrare gjermanishtfolëse (që përfshin Gjermaninë, Austrinë dhe Zvicrën) kam bërë më shumë për letërsinë shqipe se çdo njëri tjetër. Por s'kam iluzione. Çdo gjë që ke bërë ndërlllogarit me atë që s'ke bërë. Për çdo autor që kënaqet, ka dhjetë të tjerë që mbeten të zhgënjyer. Dhe të zemëruar. Një nga kolegët e mi këtu ka shpërndarë e-maile me mesazhin e lumtur: tani kam gjashtëdhjetë autorë shqiptarë në faqen time në internet! Gjashtëdhjetë autorë me, të themi, nga tri faqe, bën njëqind e tetëdhjetë faqe. Bravo! Unë nuk di saktësisht sa faqe letërsie kam përkthyer nga shqipja, por me siguri kanë qenë disa mijëra. Dhe të gjitha janë botuar në letër, janë shitur në librari, janë recensionuar në shtyp. Sidoqoftë, s'jemi në garë: unë kam kapur dhjetë peshk! Por unë kam kapur njëmbëdhjetë, ha, ha, ha!

Nuk i përkas botës letrare shqiptare, por botës letrare gjermanishtfolëse. Atje kam botuar një numër të madh përkthimesh, vepra të mjaft shkrimtarëve të të gjitha trojeve shqiptare, konsiderohem përkthyes me nam, gëzoj respektin e kolegëve dhe botuesve, puna ime

pëlqehet nga lexuesi dhe kritika letrare, jam nderuar me çmime dhe bursa. Isha midis përkthyesve që u ftuan nga presidenti i Republikës Federale të Gjermanisë për takim. Këtë gjë nuk e përmend për t'u mburrur, por për të treguar që letërsia shqiptare nuk është aq e parespektuar te ne sesa supozohet në Shqipëri. Mirë është ashtu siç është.

Jeni një tjetër gjerman me lidhje të çuditshme dhe të ngrohta me Shqipërinë dhe gjuhën tonë. A keni një kujtesë, histori për karrierën tuaj si përkthyes, kur dhe si e nisët me shqipen?

Po, ndoshta mund të thuash se në radhët e të huajve që janë marrë me Shqipërinë, numri i gjermanëve ka qenë mbi mesataren, siç tregojnë edhe emrat e shumë gjermanë në fushën e albanologjisë ndërkombëtare. Mirëpo, për hir të së vërtetës, duhet thënë se një pjesë e konsiderueshme e këtyre "gjermanëve" ishin austriakë (Johann Georg von Hahn, Franz Baron von Nopcsa, Norbert Jokel etj.). Natyrisht, ka ose kishte edhe ca dashamirës të Shqipërisë me origjinë nga Gjermania. Sa u përket lidhjeve të mia me Shqipërinë, sigurisht që kam një kujtesë, si jo. Mund të përshkruaj saktësisht nga burojnë. Ndoshta ky është një rast i mirë për të treguar këtë histori pak më hollësisht. Edhe në Gjermani më pyesin vazhdimisht: Si është e mundur që e dini shqipen kaq mirë, pa qenë shqiptar? Linda në vitin 1947 në qytetin Stuttgart, në Jugun e pjesës perëndimore të Gjermanisë së shkatërruar dhe të varfëruar të pasluftës, dhe u rrita në periudhën e "tranzicionit demokratik" të vendlindjes sime. Familja ime jetonte në kushte mjaft

modeste ekonomike, derisa babai im, një shkencëtar, në fillim të viteve gjashtëdhjetë u emërua shef i katedrës së sociologjisë agrare të Universitetit të Hohenheim-it, në qytetin tim të lindjes. (Ndoshta vlen të përmendet që ai universitet prej disa kohësh zhvillon marrëdhënie me Universitetin Agrar të Kamzës.) Gjatë rinisë sime, mbeturinat e nazizmit gjakatar vazhdonin të rëndonin mbi shoqërinë gjermanoperëndimore, gjë që bënte brezin tim rebel. Unë, qysh në moshën katërmëdhjetëvjeçare, i papjekur siç isha, kisha vendosur t'ia dedikoj jetën time letërsisë. Pas maturës në vitin 1966, fillova të studioja në Universitetin e mirënjohur të Tübingen-it. Lëndët e mia ishin gjermanistika dhe shkencat politike. Merrja pjesë në lëvizjen studenteske të këtyre viteve (e njohur si "lëvizja e gjashtëdhjetetës") që në atë kohë kishte përfshirë jo vetëm Gjermaninë, por edhe shumë vende të tjera të botës perëndimore. Meqë ne, studentët, jo plotësisht pa të drejtë, lidhnim lindjen e nazizmit dhe të metat e shoqërisë postnaziste gjermane si pasojat e një kapitalizmi të pakontrolluar, orientoheshim ndaj ideologjive majtiste. Kur lëvizja studenteske filloi të zbehej, unë i përkisja asaj pjese të saj që shpjegonte këtë venitje me "lëkundshmërinë e shtresave mikroborgjeze", duke kërkuar shpëtim te "klasa punëtore". U anëtarësova në një nga partitë të shumta "marksiste-leniniste" që sapo ishin themeluar dhe jo vetëm kaq, lashë edhe filologjinë dhe shkova të punoja në një fabrikë të industrisë mekanike, si punëtor. Për gjithsej pesëmbëdhjetë vjet të jetës sime kam fituar bukën e gojës si punëtor i thjeshtë. Nuk u





pendova kurrë që kam bërë këtë hap se më mundësonte të zgjeroja shikimin tim mbi botën njerëzore. Meqë isha anëtar i një "partie marksiste-leniniste" që, ndryshe nga shumica e këtyre grupimeve, orientohej jo ndaj Maoizmit, por ndaj Enverizmit, erdha në kontakt me Shqipërinë. Duhet të ketë qenë në vitin 1973 (ndoshta edhe pak më vonë) kur bashkë me shoqen time erdhëm për herë të parë në Shqipëri, si turistë politikë. Ngaqë isha jo vetëm aktivist besnik i "partisë", por edhe me një përgatitje profesionale të përshtatshme për një punë të tillë, partia ime na dërgoi ne – d.m.th. mua, bashkëshorten time Doris dhe të dy djemtë e vegjël (dy dhe tre vjeç) – në Shqipëri, për të punuar te Radio Tirana dhe te shtëpia botuese "8 Nëntori". Kjo ka qenë në verë të vitit 1977. Në Tiranë bashkëpunonim me shumë njerëz si ne nga mjaft vende të botës, nga Brazili deri në Suedi. Këtu nuk është vendi për t'u thelluar në përshtypjet dhe përvojat që kemi fituar në Shqipërinë e asaj kohe, por mund të them se gjatë kohës që kalonim në Tiranë, kam përvetësuar jo vetëm gjuhën shqipe, por edhe bazat e zanatit të përkthyesit.

Pas kthimit tonë në Gjermani, në fund të vitit 1980, u punësova sërish në një fabrikë, për të mbajtur familjen time ekonomikisht. Me kalimin e viteve u zgjodha "këshilltar i ndërmarrjes", d.m.th. përfaqësues i punëtorëve, dhe isha bashkorganizues i rezistencës së punonjësve për të mbrojtur vendet e tyre të punës kundër planeve të koncernit "Siemens" që kishte vendosur ta mbyllte këtë uzinë. Një gjë interesante, gati qesharake, është se pjesëmarrja ime në "luftërat proletare" ishte shoqëruar nga largimi im hap pas hapi nga botëkuptimi komunist.

Kontaktin me Shqipërinë dhe kulturën shqiptare nuk e ndërpreva kurrë. Krahas punës në uzinë, vazhdoja të përktheja vepra të letërsisë shqipe dhe për njëfarë kohe isha nënkryetar i Shoqatës së Miqësisë Gjermani-Shqipëri. Siç thashë që më parë, u distancova nga ideologjia komuniste, jo menjëherë, por brenda një kohe relativisht të shkurtër pas kthimit nga Shqipëria. Përvojat e fituara atje në kohën e diktaturës ishin një nga arsyet për këtë gjë, por jo e vetmja. Kryesisht, ka qenë një proces e qartësimit mendor dhe intelektual. Dikush nga ata gjermanë që, si ne, kanë ndenjur dhe kanë punuar në Tiranë në kohën komuniste, ka thënë në një bisedë se "po të kisha qenë në dijeni për të vërtetën e këtij vendi, nuk do të kisha shkuar atje". Nuk më duket e ndershme kjo thënie, pa marrë parasysh sa dhe çka ka kuptuar ai konkretisht për situatën në Shqipëri. Ne e konsideronim veten si marksistë-leninistë, stalinistë në fakt, dhe si të tillë – siç kam thënë në një intervistë me gazetën gjermane "Frankfurter Allgemeine" – ishim bindur se diktatura e proletariatit është e nevojshme. Ky është thelbi i problemit: ideologjitë totalitare, sistemet totalitare, kanë dhunën dhe krimin në gjak, thjesht për

shkak se uzurpojnë të drejtën t'ua imponojnë të tjerëve të ashtuquajtur të vërtetën e tyre. Dhe të gjitha këto në emër të një interesi gjoja superior, gjoja kolektiv. Por s'duhet të mbrohet turma nga individ, individ duhet të mbrohet nga turma. Ky është kuptimi bazë i Deklaratës së të Drejtave të Njeriut. Ekstremizmi i majtë dhe ekstremizmi i djathtë janë njëloj të dëmshëm dhe të rrezikshëm. Në fund të viteve tetëdhjetë të shekullit të kaluar, kur sistemi monist në Shqipëri filloi të merrte tatëpjetën, e kisha gjetur vendin tim në anën e lëvizjes demokratike shqiptare. Mjaft personalitete të shoqërisë së sotme shqiptare i kam njohur në atë kohë. Eksodi i shqiptarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë në vitet nëntëdhjetë ose, më saktë, ardhja e një numri shumë të madh shqiptarësh në Gjermani, më dha mundësinë të lija punën në fabrikë dhe të kaloja në statusin e përkthyesit me profesion të lirë. Qysh atëherë, krahas punës si përkthyes letrar, në mijëra raste kam qenë aktiv si përkthyes i gjuhës shqipe me gojë dhe me shkrim, kryesisht në institucionet e drejtësisë. Gjatë të gjitha këtyre kohëve, marrëdhëniet e mia me Shqipërinë mbeteshin të pandërprera. Ndërkohë janë bërë edhe familjare: mbesat e mia bashkë me nipin e vetëm rriten me dy gjuhë, me gjermanishten dhe me shqipen, që e mësojnë nga nënat e tyre shqiptare. Ndoshta vlen të përsëris diçka që kam thënë qysh para disa vjetësh, në intervistën e sipërpërmendur me gazetën "FAZ": Kam zor të besoj se dikush mund të ndiejë dashuri për vende, shtete, formacione shoqërore ose zhvillime historike. Prandaj jam skeptik ndaj termave të llojit "mik i Shqipërisë", "pasion për Shqipërinë" etj. Në jetën e njeriut, ndjenjat shpeshherë janë edhe kontradiktore. Me fjalë të tjera, ka shumëgjë dhe shumëkënd në Shqipëri që më pëlqen, por ka edhe shumëgjë dhe shumëkënd që nuk më pëlqen. Sidoqoftë, Shqipëria dhe shqiptarët janë bërë pjesë e jetës sime. Marrëdhëniet e mia me këtë vend dhe njerëzit e tij janë bazuar në atë që për më shumë së gjysmën e jetës sime kam qenë në kontakt të ngushtë me ta. Kam vëzhguar (dhe jo vetëm vëzhguar) zhvillimet politike, shoqërore, kulturore të këtij vendi në faza të ndryshme historike. Në njëfarë mënyre mund të thuash se e kam bërë botën shqiptare profesion. Është si në faqet: s'ka nevojë të shkosh mirë me çdo anëtar tjetër, por prapëseprapë jeni faqet.

Nga vini dhe cili ka qenë formimi juaj?

Kam folur gjatë për origjinën dhe formimin tim, por prapë dua të shtoj ca gjëra në lidhje me profesionin e përkthyesit. Siç thashë më përpara, pas maturës kam vazhduar studimet e gjuhësisë dhe letërsisë gjermane dhe të shkencave politike, deri në seminarin e fundit të detyrueshëm, por pastaj vendosa të vazhdoja shkollën tjetër, siç thamë atëherë, atë të klasës punëtore, me një idealizëm të shtrembër. Atje, por edhe më vonë, në sallat e gjykatave, kam mësuar shumë për njerëzit. Që nga fillimi i qëndrimit tim për punë në Shqipëri dhe deri më sot jam marrë intensivisht me gjuhën shqipe, me kulturën, historinë, letërsinë, me doket e zakonet e shqiptarëve, me zhvillimet politike në rajonin e populluar nga ata, me fjalë të shkurtra, me çdo gjë që ka të bëjë me shqiptarët. Jam kurioz. Interesohem për shumë gjëra. Përpiqem të mësoj gjëra të reja, edhe tani, në moshën e madhe. Hulumtoj gjërat. Kompjuteri dhe interneti kanë lehtësuar punën e përkthyesit shumë. Fjalorët dygjuhësh janë shumë të nevojshëm, por sa i përket gjuhës shqipe, në përgjithësi, nuk janë në nivelin e duhur. Të metat e tyre të bëjnë të çmendesh. Më të rëndësishëm janë fjalorët njëgjuhësh, të gjermanishtes dhe të shqipes, në këtë radhitje. Më i rëndësishmi është fjalori sinonimik. Pjesë e formimit të përkthyesit është edhe furnizimi me virtytin e durimit. Nganjëherë punon një gjysmë viti ose më shumë në një libër të vetëm. Unë, si shumica e përkthyesve të ne, punoj ngadalë, të paktën për mendimin e kolegëve shqiptarë. Pas të tre (ose katër) "raundeve" të përpunimit të tekstit të plotë kam arritur në një mesatare nga 2 faqe për ditë. Çdo formulim ka rëndësi. Përkthimet dorëzohen sipas planit të botuesit, por s'janë përfunduar kurrë.

Sa e rëndësishme është për një përkthyes të jetë në gjuhën dhe në kulturën e tjetrit, e konkretisht ju në marrëdhënie me shqipen?


Kjo njohuri, kjo përvojë, është me rëndësi elementare për përkthyesin letrar. Të jesh në gjuhën dhe në

kulturën e tjetrit është absolutisht e nevojshme. Por jo e mjaftueshme. Akoma më i rëndësishëm është zotërimi i përsosur i gjuhës në të cilën përkthen (e cila gjuhë, si parim, është gjuha jote amtare). Cilësia e një përkthimi varet kryesisht nga aftësia formuluese e përkthyesit në "gjuhën objekt" (object language, në anglisht), d.m.th. në gjuhën e lexuesit për të cilin punon, dhe jo nga aftësia e tij për të kuptuar përmbajtjen e tekstit në gjuhën e origjinës. Duhet të jesh në gjendje jo vetëm të kuptosh, të shkruash dhe të flasësh, por ta ndiesh gjuhën. Prandaj nuk mjafton të zotërosh një gjuhë të huaj shumë mirë që të plotësosh kushtet paraprake për t'u bërë përkthyes letrar. Shumë rëndësi ka edhe talenti, nuk duhet të nënvleftësohet në asnjë mënyrë. S'mund të ndërtohet një karrige, pa pasur talentin e zdukhëtarit. S'mund të përkthesh letërsi, pa pasur një talent të veçantë për këtë veprimtari. Dhe mos nënvleftëso kurrë anën zanatçore. Edhe një violinist duhet të përvetësojë shkathtësitë e duarve, duhet të praktikojë shumë orë në ditë për të shkëlqyer në koncert. Përkthimi letrar është art edhe zanat. Artizanat, ndoshta.

Talenti, një fond i shëndoshë i njohurive letrare (teorike dhe praktike), aftësitë zanatçore dhe zotërimi absolut i "gjuhës objekt" përcaktojnë vijën ndarëse midis përkthyesit profesionist dhe përkthyesit amator. Dhe duhet thënë se për përkthyes amatorë nuk ka vend në biznesin letrar. Çdo autor përgjigjet vetë për dështimin e librit të tij të dobët. Por ai është viktimë e pafajshme kur vepra e tij shfaroset nga një përkthyes i paaftë. Vihet re se dijetarët e gjuhës, por edhe shkrimtarët zakonisht, nuk dallohen në fushën e përkthimit letrar. Filologjia nuk të bën shkrimtar. Dhe as përkthyes. Përkthimi është një gjë shumë e veçantë.

Është një "konkurrencë", gjë që nuk ndodh me gjuhë të tjera, kalimi i shqipes në gjuhën gjermane... ka një shpjegim çështje kjo afri dhe pse ju është besuar aq shumë juve? A mban gjithçka pasioni?

Nuk kuptoj mirë ç'doni të thoni me fjalën "konkurrencë", prandaj nuk mund të përgjigjem. Ndoshta flisni për marrëdhëniet midis përkthyesve të shqipes në Gjermani. Ky është një problem kompleks që nuk mund të trajtohet me pak fjalë. Pse më besohet pikërisht mua? Sipas të gjitha gjasave, më besohet për shkak se bëj punën time mirë. Siç thashë më parë, një përkthim i dobët mund të shkatërrojë edhe librin më të mirë, gjë që natyrisht sjell pasoja negative financiare për shtëpinë botuese. Unë nuk dorëzoj përkthime të dobëta, prandaj punëdhënësit të mi kanë besim tek unë. Edhe lexuesit çmojnë punën time dhe nuk kursejnë më lëvdata. E njëjta gjë vlen për kritikën letrare. Me një fjali të shkurtër: *Te përkthyesit, cilësia e punës dhe jehona pozitive e publikut vendosin në çështjen e besueshmërisë.* Thashë se përkthimi i keq shfaros librin, por fakt është gjithashtu: përkthim i mirë mund të shpëtojë një libër



Kopertina e "Konzert në fund të dimrit"

jo aq të mirë, të paktën pjesërisht. Para shumë vjetësh, një autor jo i panjohur i gjuhës shqipe më ka treguar se përfaqësuesi pak i zhgënjyer i shtëpisë botuese që kishite botuar romanin e tij, i kishte thënë: “Më e mira në romanin tënd është përkthimi.” Sensi i ironisë së autorit përkatës më bënte përshtypje. Sa për pasionin: pasioni nuk mban asgjë. Por ndoshta nuk është e keqe ta kesh.

Me botimin sistematik të veprës prozaike të Kadare në vendet gjermanishtfolëse, nisur nga mesi i viteve '80, ju keni qenë i pari përkthyes i tij, nëse s'gaboj. Si u vendos për emrin tuaj, a mund të na kujtoni ç'ishte ky fillim?

Nuk kam qenë i pari përkthyes i Kadare në Gjermani, respektivisht në rajonin gjermanishtfolës. Romani i parë i Kadare në gjuhën gjermane, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, doli në vitin 1973, i përkthyer nga frëngjishtja. Në vitin 1977, i njëjti roman doli në Gjermaninë Lindore, i përkthyer nga shqipja nga albanologët Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler, të cilët para zhdukjes së shtetit të dytë në tokën gjermane botonin edhe disa libra të tjerë të Kadare. Midis vitit 1987 dhe vitit 1991, nën kujdesjen e mikut të Shqipërisë, Giuseppe de Siati-t, shtëpia botuese “Neuer Malik Verlag” botonte një seri veprash të Kadare në gjuhën gjermane, gjithsej gjashtë libra. Te shumica e këtyre botimeve viheshin re shenja të parregullsisë (ose të informalitetit, për të përdorur këtë fjalë të modës): mospërmendja e përkthyesit për shkak të sherrit me botuesin, përkthime problematike, një përkthim “i vjedhur”, probleme me të drejtat e autorit dhe gjëra të tjera të kësaj natyre. Ekzistonte dëshira e autorit t'u jepte botimeve një rrugë tjetër, më të rregullt. Libri i parë i Kadare që kisha përkthyer unë, doli në treg në vitin 1988. Ishte romani “Kronikë në gur”. Parahistoria ishte kjo: rreth vitit 1986, si student ose ish-student në qytetin austriak Innsbruck, Ardian Klosi kishte kontakt me një ish-shoqe të studimeve që punonte si redaktore në shtëpinë botuese austriake “Residenz Verlag”, në Salzburg. Gjë që shumëkush ndoshta nuk di, është që Klosi në atë kohë kishte një afërsi mjaft të madhe me Kadarenë. Ishte redaktori i tij shqiptar, fitoi doktoratën e tij me një disertacion për Kadarenë. Bile kishte edhe marrëdhënie personale me shkrimtarin. Unë, për shembull, vizitën e parë në shtëpinë e Ismailit e bëra bashkë me Ardian Klosin. Kjo ka qenë në fund të viteve tetëdhjetë, në Tiranë. Pak më vonë çdo gjë kishte ndryshuar, por për këtë nuk kam qejf të flas këtu. *De mortuis nil nisi bene*, thonë romakët e vjetër. Por ne jse. Fakt është që Ardian Klosi ngjalli interesin e shtëpisë botuese për romanin “Kronikë në gur”, por përkthimi provë nga dora e tij nuk gjeti pëlqimin e redaktores dhe të botuesit, Jochen Jung. Prandaj Ardiani më propozoi mua dhe përkthimi im provë u pëlqye shumë. Mora kontratën e përkthyesit, romani u botua me mjaft sukses dhe besoj se deri tani është libri i Kadare në gjuhën gjermane me ribotimet më të shumta. Për sa i përket veprës së Kadare, ky ka qenë fillimi. Pas kësaj, shtëpitë botuese gjermane të tij kanë ndryshuar dy herë, por përkthyesi ka mbetur i njëjti, unë. Deri më sot kam përkthyer afro pesëdhjetë vepra të Kadare, romane, novela, tregime, ese, përmbledhje poezish, që u botuan në tregun e librit gjermanishtfolës. Libri i fundit do të dalë sivjet, në tetor: një përmbledhje e teksteve autobiografike me lidhje me Gjirokastrën, duke përfshirë edhe romanin “Kukulla”. Me sa duket, për publikun letrar në Gjermani, Austri dhe Zvicër jam shkrirë në njëfarë mënyre me autorin, si zëri i tij gjerman.

Pothuajse të gjithë përkthyesit e vonshëm të veprës së Kadare kanë pasur kontakte me Shqipërinë e periudhës së izolimit – çfarë ka lënë më shumë gjurmë te ju? Në atë kohë, siç e dimë, i përkisnit Gjermanisë Lindore.

Së pari, nuk jam i Gjermanisë Lindore, siç kam treguar më parë. Por është e vërtetë që gjatë kohës së komunizmit kemi jetuar tre vjet e gjysmë në Shqipërinë komuniste, si familje. Qëndrimi në Shqipërinë e asaj kohe ishte, si ta them: disi i veçantë, kërkues, por do të ishte gënjeshtrë po të thosha që e ndienim veten keq atje. Sot më kap tmerri, ose me saktë: turpi, kur kuptoj se çfarë ka ndodhur në atë kohë në Shqipëri, sa njerëz të pafajshëm vuanin në burgje, kampet dhe vendet e internimit. Dua të përmend Musine Kokalari në



Rrëshen, një grua të jashtëzakonshme. Pa harruar të gjithë të tjerët. Ju pyetët për gjurmët që ka lënë kjo kohë tek unë. Këto janë. Dhe nuk do të shuhen kurrë. **Nëse për një nismë të mbarë afirmimi në domenin frankofon të Kadare meritë të çmuar ka përkthyesi Jusuf Vrioni, për hapësirën gjermanishtfolëse do thoshim pa hezitim se e keni ju, – çfarë sfide ka qenë përkthimi i veprës së tij?**

Mos ma merrni për mendjemadhësi, por pas më shumë se tridhjetë vjetësh si përkthyesi gjerman i Kadare dhe pas gjermanizimit të një numri kaq të madh të veprave të tij, mund të them: Nuk ka më sfide për mua. Kjo i detyrohet edhe faktit që Kadareja është një autor absolutisht komplet, me një profesionalitet të rrallë. Gjuha e tij është e kthjellët si ujë, e tejdukshme. Gjatë karrierës sime të gjatë kam përkthyer edhe ca libra, autorët e të cilëve – me ose pa diplomë në lëndën e gjuhësi-letërsisë – dukshmërisht nuk kishin as idenë më të vogël për parimet e ndërtimit të një romani, për mbajtjen e harkut të tensionit, krijimin e marrëdhënieve të gjalla midis personazheve dhe gjëra të tjera elementare. Pa folur këtu për zotërimin e gjuhës. Këtyre vepruesve u mungonte profesionalizmi, megjithëse ishin furnizuar me njëfarë talenti. Por, sigurisht, ka edhe shembuj të tjerë, pozitivë. Them me vetëdije të plotë: bota shqiptare mund të jetë e lumtur të ketë një shkrimtar si Ismail Kadare.

Kujtojmë se në fillim të '90-ës ka pasur një debat të ashpër në Gjermani sa u takon librave të autorëve të botuar në kohën e komunizmit në Gjermaninë Lindore. Ata kritikë e gazetarë, siç mësohet, kishin kaluar kohën e tyre, më parë, në komunizëm në një rehati dhe se nuk kishin idenë e diktaturës shqiptare... si qëndronte çështja në të vërtetë, keni një vështrim nga kjo distancë e sotme?

Po, në konferencën e Departamentit të Letërsisë të Universitetit të Tiranës, “In Honorem, Kadare”, në vitin 2016, mbajta një kumtesë për këtë temë. Në këtë kumtesë thashë se në Gjermaninë e viteve nëntëdhjetë, pas rënies së Murit të Berlinit dhe ribashkimit të vendit, filloi një debat i ashpër për vlerësimin, respektivisht rivlerësimin, e letërsisë në Gjermaninë Lindore dhe pastaj në gjithë Gjermaninë, pas Luftës së Dytë Botërore. Protagonistët sulmues në redaksitë kulturore të disa gazetave gjermanoperëndimore përdornin këtë debat (që pas pak u titullua “Polemika letrare gjermano-gjermane”) për të vënë në dyshim gjithë prodhimtarinë letrare të pasluftës në ish-vendet të Europës Lindore. Ismail Kadareja ishte midis viktimave të kësaj polemike, gjë që, bashkë me disa faktorë të tjerë, shkaktoi një ndërprerje disavjeçare të botimeve të tij në gjuhën gjermane. Gjithashtu, thashë se kundërshtarët e Kadare në gazetën gjermanishtfolëse, midis tyre edhe disa që pak kohë më përpara e kishin lavdëruar veprën e

tij dhe me ndryshimin e konjunkturave ishin konvertuar dhe kishin kaluar në anën e kundërshtarëve të tij për të qenë brenda, të gjithë kishin jetuar gjithmonë në kushtet e një sistemi tolerant demokratik dhe nuk kishin për të mbajtur mbi trup barrën e një regjimi totalitar. Tregova që kulmin e sulmeve kundër Kadare në shtypin gjerman e përbënte një recension në një nga gazetën më prestigjioze të Gjermanisë (“Frankfurter Allgemeine Zeitung”) nga dora e një prej ish-adhuresve të sipërpërmendur të veprës së Kadare, ku mes të tjerave u përmend edhe shprehja “diktatura Hoxha-Kadare”. Kjo fjalë monstruoze ishte importuar drejtpërdrejt nga Shqipëria dhe vinte nga rrethet e kundërshtarëve të përhershëm dhe të sapokonvertuar të Kadare atje. Pra, kundërshtarët e Kadare në Gjermani ishin nxitur dhe municionuar nga armiqtë e vjetër e të rinj të autorit të madh në Shqipëri, dhe jo pa dashje. Vazhdova se unë për veten time gjithmonë e kam pasur të vështirë të kuptoj motivet e grupit ose, më mirë, të grupeve të ndryshme të militantëve antikadareianë, sidomos egërsinë primitive të mësymjeve të tyre. Askush nuk ka për detyrë t'i çmojë librat e Kadare dhe asnjërit nuk mund t'i mohohet e drejta për të kritikuar autorin, edhe për qëndrimet e tij politike ose personale nëpër kohë. Por kritika duhet të bazohet në arsyetim dhe jo në armiqësi personale, xhelozë, zili ose thjesht urrejtje, dhe duhet të zhvillohet në mënyrë të qytetëruar, pa cenuar dinjitetin personal dhe profesional të të kritikuarit.

Në kushtet e regjimit jashtëzakonisht të egër dhe shpirtlig komunist në Shqipëri, Ismail Kadareja, në veprimtarinë e tij, është treguar absolutisht mospërfillës ndaj dogmës estetike zyrtare të realizmit socialist, duke krijuar një veprë letrare të denjë dhe me peshë botërore. Dhe bota zakonisht i gjykon të gjithë shkrimtarët në bazë të veprave dhe jo të vetive personale të tyre.

Prandaj, thashë, e kam shumë të vështirë të kuptoj përmasën tmerruese të sulmeve kundër tij, sidomos kur shoh se në të njëjtën kohë disa nga protagonistët kryesorë të letërsisë së realizmit socialist në Shqipëri kanë mbetur fare të paprekur, madje vazhdojnë të nderohen, dekorohen, kurse veprat e tyre prototipike socrealiste ruajnë vendin e tyre të nderuar në fondin e letërsisë kombëtare, bile duke u konsideruar si xhevahire letrare. Gjithashtu, thashë se realizmi socialist me shabllonet dhe stereotipat e tij propagandonte në mënyrë skematike idetë komuniste, duke i shkrirë me një nacionalizëm romantik aq patetik sa edhe bajat. Ai është bërë mishërimi i këtyre veseve në fushën e estetikës. Elemente përbërëse të një veprë prototipike të realizmit socialist janë denoncimi, ndjekja, diskriminimi, burgosja dhe shpeshherë edhe eliminimi fizik i të ashtuquajturve “armiqtë e klasës”; arsyetimi ose justifikimi i poshtërimin të skajshëm të një numri të madh njerëzish të pafajshëm vetëm për shkak të rrethanave të tyre familjare, botëkuptimore, seksuale e kështu më radhë, të cilëve u mohoheshin të drejtat elementare e njeriut; thjeshtëzimi deri në karikaturë të marrëdhënieve shoqërore (o mik, o armik); etablimi i urrejtjes si element bazë i shoqërisë dhe politikës edhe në letërsi; justifikimi i një diktature të përgjakshme të një pjese të popullsisë mbi tjetrën (në teori) gjegjësisht (të udhëheqësve të Partisë) mbi gjithë popullsinë (në praktikë), e të tjerë. Sot ka përfunduar “polemika letrare gjermano-gjermane”, i përket historisë, dhe gjithashtu “bojkotimi” i përkohshëm i veprave të Kadare në botën gjermanishtfolëse, të rrjedhur prej saj.

Shkrimtarët shqiptarë duhet të shkruajnë histori njerëzore, të merrem me realitetin e vendit të tyre dhe të mos qëndrojnë indiferentë – shpesh ju keni qenë shumë i ashpër për mënyrën sesi shkruhet letërsia shqipe, herë me sugjerime, herë me këshilla dhe herë me sulme e armiqësi... si ia keni dalë, pse ky mur i fortë mes jush si “gjerman” dhe shqiptarëve që kërkohet me ngulm afirmimin... Çfarë ka qenë kjo periudhë, në këtë paradoks? Ju lutem, mur midis gjermanit dhe shqiptarëve të shkretë afirmimkërkues? Sulme, armiqësi?!

Sa i përket dëshirës për afirmim: këtë dëshirë e ka çdokush midis shkrimtarëve në këtë univers. Por jo gjithmonë ekzistojnë parakushtet objektive për të arritur këtë afirmim. A mund të plotësohet dëshira e kërkuesit, varet nga faktorë të shumtë, jo vetëm objektivë, por edhe subjektivë. Për sa i përket armiqësisë: si ndjekës

i rregullt i shtypit shqiptar në internet mund të them se kam një ide relativisht të qartë për stilin dhe tonin e debateve publike në Shqipëri: sulme të pamëshirshme në bazë të një tifoze partiak dhe botëkuptimor, me fyerje, shpifje, akuza, kërcënime. Mua më pëlqen të quaj këtë fenomen “luftën e istikameve”, duke ditur që bashkëbiseduesit të mi shqiptarë do të më bëjnë vërejtje, do të theksojnë se në gjuhën e sotme shqipe përdoret fjala “llogore”. Në rregull, por në këtë kontekst termi i vjetër më duket më i përshtatshëm. Pra, në këtë kasaphanë e gjithanshme që quhet debat, secili mbron me vendosmëri pozitën e tij të fortifikuar, duke shtirë me armë të rënda në çdo drejtim ku e nuhat kundërshtarin. O shok, o kundërshtar. O Partizani, o Tirona. O demokrat, o socialist. O mik i Shqipërisë, o armik i Shqipërisë. Duhet të them se në krahasim me polemikat e përditshme shqiptare, mënyra ime e diskutimit më duket relativisht e qytetëruar. Por besoj se këtu ekziston një paradigmë tjetër shqiptare: ne dimë fare mirë që kemi defektet tona, por ama, jemi populli i Skënderbeut, dhe këta të huaj, europianët, amerikanët, përkthyesit, nuk kanë të drejtë të na kritikojnë! Ose të na ironizojnë! Kërkoj falje, por në ambientin tim kulturor konsiderohet si normale të bëhen vlerësime cilësore dhe përmbajtësore, përfshirë edhe kritika, mjafton të jenë të arsyetuara, të ekuilibruara dhe me motive pozitive. Si gjermanë jemi mësuar që popujt e tjerë të na shfaqin mospërfillje dhe refuzim, dhe duhet thënë se nga ana historike e kemi merituar. Ne dimë fare mirë që kjo gjë mund të jetë e dhimbshme. Por me gjithë mirëkuptimin tim për ndjeshmëritë kombëtare mendoj se nganjëherë vlen të dëgjosh edhe kur flet një i huaj. Ose një “armik”.

Pikërisht ata shkrimtarë shqiptarë që kanë qejf të ankohen me zë të lartë për indiferencën e botës së jashtme ndaj veprave të tyre dhe fajësojnë përkthyesit dembelë për këtë gjë (mua më kujtohet një konferencë me përkthyes të huaj në vitin 2003 ose 2004 në Tiranë, ku këto ankesa ishin përmbajtja kryesore e aktivitetit), do të bënin mirë të mbanin një qëndrim më tolerant ndaj vërejtjeve mirëdashëse që u bëhen nga jashtë. Me citatin që përmendët (“histori njerëzore”), besoj se desha të thosha atëherë (biseda jonë në “Friend’s Book House” u zhvillua para shumë kohësh) se disa përfaqësues të letërsisë bashkëkohore shqiptare më mirë të pasqyronin ndryshimet në botën e brendshme të njerëzve, problemet e tyre psikologjike (pse jo) edhe shoqërore dhe ekonomike në këtë fazë të vështirë tranzicioni, në vend që të thelloheshin në eksperimente të pafrytshme në emër të një avangardizmi aq eklektik sa edhe të konsumuar.

Për mua është çudi sa pak krijues letrarë merren letrarisht me hulumtimin e gjendjes aktuale të shoqërisë shqiptare. Unë nuk jam kundër pasqyritimit letrar të kohës së sundimit komunist – ky sundim ka shkaktuar trauma të rënda dhe në asnjë mënyrë nuk duhet harruar. Por gjërat i nënshtrohen zhvillimit, pasojat e kësaj traume gjithashtu, ka edhe trauma të reja, dhe letërsia, sa për mendimin tim, nuk mund të qëndrojë indiferente ndaj këtyre sfidave. Ose, duke vënë veten në pozitën e njerëzve të huaj që tashmë në mënyrë masive kanë filluar të vijnë në Shqipëri si turistë: Sot, në fund të dekadës së dytë të shekullit XXI, do të ishim mirënjohjes po të na shpjegonte dikush çfarë po ndodh në këtë vend akoma pak të padepërtueshëm dhe të mos mësojmë vetëm për të kaluarën aq tragjike sa edhe heroike.


Nuk jeni vetëm ju, por edhe përkthyes të tjerë të cilët jo pak herë kanë pasur një lloj përballje me “arrogancën e shkrimtarëve shqiptarë” dhe maninë e tyre për t’u përkthyer medoemos... A keni pasur një shpjegim ç’ishte kjo skenë letrare në Shqipëri?

Nuk do ta quaja “arrogancë”. Më shumë më duket si një shenjë e pasigurisë ose si shprehje e njëfarë (më falni) kompleksi të inferioritetit, të kthyer në shpirt sulmues. Çdo krijues, domethënë edhe çdo shkrimtar, kërkon afirmim publik për veprën e tij, siç thashë qysh përpara. Në rregull, le ta kërkojë dhe ta gjejë këtë afirmim te rrethet letërsidashëse të vendit ku zhvillon veprimtarinë e tij. Në rastin tonë, në Shqipëri. Shqipëria është vend i vogël dhe relativisht i vogël është edhe numri i lexuesve. Sistemi i botimeve mund të konsiderohet të paktën si “akoma i pazhvilluar”. Çdokush që disponon shumën e nevojshme të të hollave mund të botojë prodhimin e tij

pak a shumë letrar, pavarësisht nga cilësia e veprës, gjë që shkakton tretjen ose bile zhdukjen e vijës ndarëse midis letërsisë profesioniste dhe letërsisë amatore. Mirëpo, ajo vijë ndarëse është e domosdoshme për zhvillimin e një letërsie të shëndoshë. Me të meta është edhe sistemi i shpërndarjes së librave (libraritë). S’ka kritikë letrare që mund të quhet e pavarur dhe objektive. Ose e guximshme. Dhe në Shqipëri, si në gjithë botën, interesi për letërsinë e shtypur në letër fatkeqësisht gjendet në rënie, për shkak të mediave e reja, digjitale. Në kushte të tilla, kjo është përshtypja ime, lexuesi shqiptar nuk gëzon më besimin e shkrimtarëve shqiptarë. Afirmimin e dëshiruar shpresojnë ta gjejnë drejtpërsëdrejti te lexuesi i huaj, duke kapërcyer me një hap të vetëm disa stade të zhvillimit të famës letrare. Fatkeqësisht, gjërat nuk funksionojnë ashtu. Pa një karrierë solide, shumëvjeçare, në vendin tënd as nuk mund të përpiqesh “të pushtosh botën letrare”. Por edhe me një karrierë të tillë nuk e ke të garantuar që ylli yt do të lindë edhe në Europë, në Australi ose në Amerikë. Më është krijuar përshtypja se për mjaft autorë shqiptarë ka më shumë rëndësi të përkthehen sesa të pëlqehen jashtë. Të jesh i përkthyer përmirëson statusin tënd shoqëror brenda vendit. Suksesi i librit në tregun e huaj është me rëndësi të dorës së dytë. Ose pa rëndësi fare. Ky është një problem serioz. Nuk është aq e vështirë “të përkthehesh” dhe libri bile mund të botohet. Flas për këto “shtëpi botuese vetëpagueuse” që mbijnë si kërpudhat pas shiut, edhe te ne. Po të kesh të hollat, mund të botosh çdo gjë. Autori duhet të harxhojë katër-pesë mijë euro (ose shumë më shumë, pa marrë parasysh këtu shpenzimet “anësore”, p.sh. për përkthimin) për t’ia plotësuar vetes dëshirën për t’u botuar. Vetëm që duhet thënë se librat që dalin nga një “shtëpi botuese” e tillë, nuk do të arrijnë kurrë në libraritë, domethënë te publiku letrar. Nuk do të merren parasysh nga kritika letrare. Autorët e tyre nuk fitojnë të drejtën të anëtarësohen në organizatat profesionale. Kjo do të thotë se libri mund të quhet i djegur që përpara se ka dalë. Ky është një ligj i pashkruar, një çështje e etikës profesionale. Çdo botim i padenjë, çdo libër i dështuar në tregun e huaj, ndikon negativisht në shanset e veprave të denja të të gjithë autorëve të një vendi për t’u botuar jashtë. Mirëpo, s’ka gjë, autori mund të shpërndajë dyqind copët e tirazhit për të cilin ka paguar falas, vetëkuptohet – në farefis ose në rrethin e miqve. Po të kënaqet me një “afirmim” të tillë.

Ju keni thënë prerë se e vetmja mundësi për t’u njohur në qarqet e jashtme letrare është interesi i lexuesve të atij vendi ku përkthehen? A vazhdon të qëndrojë kjo? Sot ka politika të posaçme qoftë edhe nga BE-ja, pasi lexuesi nuk është më ai i një dekade më parë.

Po, them prerë se për suksesin e një libri (qoftë



vendas, qoftë i huaj) vendosin lexuesit dhe kritika letrare, si arbitrat më të pamashtrueshëm. Dhe më të pamëshirshëm, po të duash. Kush tjetër mund ta kryente këtë punë? Ky parim qëndron, sot dhe përgjithmonë. Kjo gjë s’varet nga koha. Por besoj se pyetja juaj synon në diçka tjetër: ndryshimet kulturore midis vendeve ose rajoneve të ndryshme. Nuk flas për “kulturën e lartë” të salloneve letrare dhe të muzikës, të teatrove ose ekspozitave, por për kulturën e përditshme, sipas “konceptit të zgjeruar të kulturës”. Me këtë term përcaktohet një sistem orientues i përbërë nga rregulla, ligje, doke e zakone, tradita, moda, botëkuptime, gjeste, stile artistike ose muzikore, rituale përshëndetjeje e lamtumire, shije, tabu, gjuhë, zhargone, vlera, shkathësi të jetës së përditshme, njohuri sociale, aftësi të fituara me anë të arsimit dhe kështu me radhë. Shkurt: një sistem vlerash dhe rregullash që ia mundëson individit të bashkëjetojë me individët e tjerë të së njëjtës shoqëri. Nuk mund të vihet në dyshim se receptimi gjegjësisht, suksesi i një veprë artistike në një vend të huaj varet, edhe nga përputhshmëria e të dyja kulturave. Filmata “Bollywood” nga India nuk pëlqehen në Europën Perëndimore sa në Azi. Për arsye të kuptueshme, lexuesi ka dëshirë të lexojë libra që “ia prekin nervin”, që janë në përputhje me përvojat dhe standardet e tij kulturore. Nga ana tjetër, edhe diçka shumë e huaj mund të gjejë interesin e tij. Niveli i arsimit ndikon në shijen e të interesuarit, d.m.th. në gatishmërinë e tij për t’u mësuar me gjëra të huaja.

Kjo është një nga arsyet pse vetëm një numër i vogël i veprave letrare të një “letërsie nacionale” (nëse duam të përdorim këtë term pak të mykur) arrijnë të kapërcejnë kufijtë për jashtë. Mentaliteti francez ose amerikan i është më afër lexuesit gjerman sesa mentaliteti kinez ose japonez. Megjithatë, një autor si Haruki Murakami është shumë i dashur për publikun gjerman.

Sot në Europën Perëndimore si dhe në Amerikë (dhe në vende të tjera perëndimore) vihet re përshtypja e procesit të “individualizimit të shoqërisë”. Aspekteve personale, private ose grupore, të seksit, të mjedisit të veçantë e kështu me radhë, u jepet gjithmonë e më shumë rëndësi, në krahasim me interesat gjithëshoqërore. Shqipëria, nga ana tjetër, për arsye historike që s’kanë filluar vetëm me komunizmin, vazhdon t’u përkasë më shumë “shoqërive kolektive”, ku normave dhe kërkesave gjithëshoqërore, në krahasim me nevojat individuale, u jepet akoma më shumë peshë. Sa i përket individualizimit të shoqërisë, flitet edhe për “diferencimin e koncepteve për jetën”. Në vendet e ish-Lindjes, për arsye historike, ky proces zhvillohet më ngadalë. Shoqëria shqiptare ka ruajtur mjaft elemente ose tipare të një “shoqërie kolektive”, për shkak të “kolektivizimit komunist”, por edhe të traditave më të vjetra. Shikimi shqiptar mbi botën nuk është akoma identik me shikimin mbi botën (për shembull) në Gjermani.

Shkurt: sa i përket kulturës së përditshme, hendeku midis Shqipërisë dhe Perëndimit nuk është mbushur akoma, në mjaft drejtime. Por nuk dua të thellohem në “problemet ndërkulturore”.

Më falni për këtë leksion në lëndën “interkulturalitet” nga shkenca kulturore, respektivisht shkenca e përkthimit. Faktorë të tillë ndikojnë me siguri në pranueshmërinë e një veprë letrare jashtë vendit të origjinës. Por, në fund të fundit, vendos cilësia.

Si është harta e përkthimeve të letërsisë shqipe në gjuhën gjermane, a keni një panoramë për këtë, ndër vite?

Në përgatitje të një aktiviteti letrar kam bërë një listë të gjitha botimeve letrare shqiptare në gjuhën gjermane, në periudha të ndryshme, dhe nuk kanë qenë aq pak. Këtu nuk mund të numëroj të gjitha botimet përkatëse. Nuk do të ishte me kuptim. Aktualisht, sipas shumë gjasave, në gjithë botën, por të paktën në Europën Perëndimore, ndodh njëfarë “përmbyseje” në tregun e librit. Është bërë më e vështirë për të botuar libra. Kjo vlen akoma më shumë për libra të huaj.

Por, siç thashë më parë, në fund të fundit, vendos cilësia.

Po pritja, receptimi?

Sa i përket receptimit, nuk ka ndonjë gjë të veçantë për t’u përmendur. Kadareja nuk mund të quhet “autor bestsellerash”, por shifrat e shitjes së librave të tij


janë në rritje, jehona nga ana e kritikës letrare është kryesisht pozitive, domethënë, shkrimtari është bërë një "faktor fiks" në skenën letrare gjermanishtfolëse. Si në shumë vende të tjera. Sa u përket veprave të autorëve të tjerë të gjuhës shqipe, receptimi prapë është normal: nganjëherë më i mirë, nganjëherë më i keq. Ndonjë sukses spektakolar nuk është për t'u shënuar kohët e fundit. Për arsyet e sipërpërmendura (sidomos rolin në rritje të mediave të reja) nuk është bërë më e lehtë, por më e vështirë për të ngjallur interesin e shtëpive botuese. Dhe interesin e publikut. Por në përgjithësi mund të thuash se ka pak vepra me vlerë të veçantë nga letërsia ndërkombëtare që nuk janë botuar në Gjermani. Presim që nga Shqipëria të dëgjoen zëra të vjetër dhe të rinj, por sidomos të rinj, dhe në fund të fundit do të vendosë cilësia.

Ka një mendësi shqiptare sa u takon përkthyesve të huaj, të cilët bëjnë bujë këtu më shumë sesa njihen në vendet e tyre. Sa garantor për cilësi mund të jetë një përkthyes i huaj, pra sa i besohet?

Sipas përvojës sime, kjo mendësi shqiptare nuk është plotësisht e gabuar, të paktën sa i përket gjuhës gjermane. Edhe mua më është dukur shpeshherë se disa nga "përkthyesit e njohur" kanë investuar më shumë energji në ruajtjen e imazhit të tyre në Shqipëri sesa në ushtrimin e suksesshëm të profesionit të tyre të përkthyesit. Me sa duket, ishin të mendimit që me lavdërime dhe lajka për arritjet shqiptare në fushën e letërsisë mund të fitonin më shumë simpati në Shqipëri sesa me suksese reale në tregun e librit të vendeve gjermanishtfolëse. Ashtu u bënë "përkthyes të njohur" në vendin e shqiptonjave, por jo në vendet e tyre. Më shumë nuk dua të them për këtë çështje. Por besoj se roli i përkthyesve përgjithësisht mbivleftësohet në Shqipëri. Ushtruesve të shkrutës të këtij profesioni u ngarkohen detyra të ndryshme që s'u takojnë, për shembull, ajo e agentit letrar, e ndërmjetës kulturor, e promovuesit, e këshilltarit, e përkrahësit shpirtëror, e ngushëlluesit dhe pjesërisht edhe e botuesit. Mirëpo, si garantuesi i një përkthimi optimal (me çdo kusht edhe në çdo rast) përkthyesi është i pazëvendësueshëm. Fatkeqësisht, në këtë funksion çmohet më pak.

Çdo shkrimtar ka dëshirë të njihet jashtë, por kjo është dëshirë joreale, sepse një autor që të ketë sukses, do parakushtet përse është shitur letërsia, nuk është për t'u mburrur. Di që ka shkrimtarë shqiptarë që bëjnë vetëmashtrim në Itali, - kjo është një deklaratë juaja në një intervistë z. Röhm. Sipas jush, cili është parimi bazë për përkthyesin?

Është e vërtetë, çdo shkrimtar ka dëshirë të njihet jashtë, kjo është për t'u dënuar. Vetëm që na del pyetja: Ç'do të thotë të njihesh jashtë? Kam thënë që më lart se është gjëja më e natyrshme që vetëm një pakicë autorësh ka kapacitetin dhe potencialin letrar për të kapërcyer kufijtë të vendit të vet për t'u njohur jashtë. Kjo vlen për shkrimtarët gjermanë, shkrimtarët frëngë, shkrimtarët amerikanë, shkrimtarët malajzianë dhe shkrimtarët shqiptarë. Që të kënaqesh ose bile të mburresh me një "sukses" të tillë që të ka botuar ndonjë shtëpi botuese e kategorisë së tretë në Italinë e Jugut ose në Malajzinë e Veriut, pa u marrë vesh nga publiku letrar dhe gazetaret e vendit përkatës, për mendimin tim është vetëmashtrim. Për mua, kjo çështje ka të bëjë me dinjitetin, për shkrimtarin dhe për përkthyesin. Unë marr rregullisht mesazhe nga autorë dhe "autorë" që më lusin ose më kërkojnë me ton pak a shumë të ashpër të përkthej prodhimet e tyre letrare. Para ca vjetësh, një vajzë në moshën e një gjimnazisteje më ka dërguar një e-mail të tillë: "Unë sapo kam botuar vëllimin tim të parë me poezi dhe dua ta përkthej në gjermanisht." Çfarë absurditeti! Unë sapo kam botuar, unë dua ta përkthej. Ju lutem, kush e boton, kush e përkthen? Vëllimthin e parë? Unë vetë kam një parim të pandryshueshëm: unë kurrë, në asnjë mënyrë, nuk marr porosi, pra para, nga autori, pavarësisht nga fakti që mund të isha shumë më i pasur po ta bëja. Kjo për mua është një çështje e integritetit profesional. Gjithashtu nuk punoj për "shtëpi botuese vetëpaguese" që, siç tregova më përpara, ekzistojnë edhe te ne, pa qenë në gjendje të hyjnë në rrjetin normal të furnizimit të librarive. Po të bëja, kjo do të ishte fundi i karrierës sime si përkthyes. Një autor që boton në një "shtëpi botuese" të tillë dhe një përkthyes që bën



të njëjtën gjë do të konsiderohen si leprozë në skenën letrare. Kjo shprehje nuk është shumë e tepruar.

A ka ndikuar te botuesit e huaj historia jonë e izolimit 45-vjeçar për të besuar te shkrimtarët, letërsia e vendit tonë? Kam parasysh shqetësimin që keni pasur ju, por siç janë shprehur përkthyes të tjerë, p.sh i ndjeri Ramon Sanches, se e gjithë pasuria e letërsisë botërore dhe rrymat letrare janë pasqyruar dhe janë përqafuar vonë në Shqipëri.

Historia juaj e izolimit 45-vjeçar nuk ka ndikuar të botuesit tanë për të besuar te shkrimtarët, letërsia e Shqipërisë. Botuesit te ne nuk pyesin nga vjen një libër i mirë. Kjo gjë vërtetohet nga suksesi i mjaft autorëve që kanë jetuar në vende me regjime diktatoriale, fashiste ose komuniste: Pablo Neruda, José Saramago, Vladimir Majakovskij, Boris Pasternak, Wisława Szymborska, Václav Havel, Imre Kertész, i cili ka mbijetuar të dy llojet e sistemeve totalitare, Ismail Kadare.

Por izolimi i Shqipërisë gjatë viteve të sistemit monist patjetër ka lënë gjurmë në letërsinë shqiptare dhe mbeturinat e këtyre gjurmëve ndoshta kanë penguar dhe pengojnë afirmimin, përhapjen e letërsisë shqiptare nëpër botë. Ramoni patjetër ka pasur të drejtë. Me sa di nga bisedat me të, edhe ai ka qenë i mendimit që izolimi kulturor pesëdhjetëvjeçar i Shqipërisë ka ndikuar negativisht në letërsinë shqiptare. Por ai u përkiste radhëve të përkthyesve profesionistë me një njohuri të shëndoshë letrare dhe dinte të dallonte të aftët nga të paaftët, të talentuarit nga të patalentuarit, pa iu nënshtruar paragjykimet ideologjik. Ose historik.

Izolimi kulturor i Shqipërisë në periudhën enveriste nuk ka shkaktuar vetëm mbetjen jashtë nga skena letrare e vendit të pjesës më të madhe të trashëgimit letrar botëror, por në mënyrë aktive janë importuar pikërisht ato pjesë të letërsive ndërkombëtare që mbështesnin ideologjinë sunduese. Mund të thuhet se janë shtrembëruar standardet. Në Shqipëri, për mendimin tim, njohuria për rrymat kryesore letrare (ose kulturore, në përgjithësi) të botës në shekullin e fundit vazhdon të jetë mjaft fragmentare, gjë që përkrah tendencat eklektike. Sidomos në vitet e para të tranzicionit vihej re përqafimi eklektik i rrymave avangardiste, të ndaluar deri në momentin e rënies së komunizmit, shpeshherë pa marrë parasysh se avangardizmat përkatëse ishin konsumuar në botë qysh pesëdhjetë vjet më parë. E njëjta gjë vlen për postmodernizmin. Ose për realizmin magjik posaçërisht të dashur. Gabriel García Márquez, surrealistët francezë, postmodernistët e të gjithë kontinenteve ose një Franc Kafka shumë i keqkuptuar ishin mjaft të pranishëm në jetën letrare shqiptare, më pak me librat e tyre sesa në veprat e autorëve shqiptarë. Kjo prirej për t'u orientuar ndaj rrymave të suksesshme të letërsisë botërore ishte e shpjgueshme,

por prapëseprapë problematike. Originaliteti është një virtut i rëndësishëm i veprës letrare. Eklektizmi është një tipar dallues i letërsisë amatore. Tani, me sa duket, situata është normalizuar, por kanë mbetur boshllëqe për t'u mbushur. Një pjesë e fajit i përket ndoshta edhe sistemit (akoma) të ngurtësuar të arsimit në Shqipëri. Faj ka edhe puna akoma disi amatore e shtëpive botuese që s'bëjnë punën (detyrën) e tyre për të ngritur në mënyrë sistematike thesaret e letërsisë botërore në sipërfaqen shqiptare. Them "në mënyrë sistematike", sepse botime ka sa të duash, por shumë herë janë bërë pa shumë kriter dhe jo gjithmonë është realizuar cilësia e nevojshme e përkthimit.

Pa tentuar të hyni në ndërmjetësin letrar, por duke konstatuar njëkohësisht, ju keni thënë se nuk i nënshtroheni shijes shqiptare, por shijes gjermane... Sa rëndësi ka për ju skena e brendshme letrare? Sa ju ka ndihmuar kjo në rolin tuaj si përkthyes?

Kam cekur këtë temë. Por nuk është në radhë të parë një çështje e shijeve, por e standardeve kulturore. Për cilën skenë të brendshme letrare flitni? Atë në Shqipëri ose atë në Gjermani? Skena gjermane është "vatra" ime. Sa për skenën shqiptare: nuk di aq shumë për këtë. A ka një skenë letrare në Shqipëri? Nëse po, nuk duket të jetë shumë e gjallë. A ka ndonjë "underground"? Shkëmbime të gjalla me lexuesit? Lexime me diskutime? Debate në shtyp? Emisione letrare në TV? A ka forume për këmbimin e mendimeve, vendtakime të rregullta të autorëve dhe përkthyesve? Ç'u bë me grupet letrare, p.sh. "E për7shmj", "Aleph" etj.? Nuk di.

Por është interesante që të huajt, turistët, që kanë filluar të vizitojnë Shqipërinë më shumë, konstatojnë se kryeqytetit, Tiranës, i mungon një profil i qartë kulturor.

Para disa vjetësh në një bisedë tonën ju sugjeroni që të hidhej vështrimi nga letërsia amerikane, duke e rrëfyer si superfuqi letrare që ka thithur gjithë debatet e sotme letrare, ku janë të përjashtuara rregullat akademike. Shembull merrni Philip Roth... a mendoni se ka letërsi kombëtare, çfarë raporti krijon letërsia me kombin? Ju e keni pasur për zemër këtë trajtesë...

Në këtë bisedë shumë vjet prapa përmenda letërsinë amerikane në një kontekst të veçantë. Thashë se në letërsinë shqipe të kohës së tranzicionit vihet re një mosbesim kundrejt realizmit në letërsi, i cili mund të shpjgohet me përvojën fatale të realizmit socialist. Shtova që sipas mendimit tim ky mosbesim është i panevojshëm, bile pengesë. Si shembull për një realizëm mjaft të suksesshëm përmenda neo-realizmin amerikan. Roth-in. Me kaq. Nuk dua t'u imponoj shkrimtarëve shqiptarë ndonjë rrymë të letërsisë botërore, as neo-realizmin amerikan, as postmodernizmin, as pospostmodernizmin, as neo-romanticizmin, as... Ndërkohë ka mjaft autorë amerikanë në raftet e librarive shqiptare (tiranase). Përzgjedhja mund të ketë qenë pak spontane, sipas njohurisë dhe qejfit të përkthyesit. Mua personalisht më ka gëzuar botimi i romanit "Stoner" i John Williams, në përkthim të Piro Mishës. Është një libër i jashtëzakonshëm.

Sa i përket "letërsisë kombëtare", besoj se ky term i përket filologjisë. Shumë mirë që filologët analizojnë veprat letrare që janë bërë brenda një periudhe të caktuar dhe kur të gjejnë tipare të përbashkëta, ndërlihdese, atëherë mund të flasin për tiparet e përbashkëta të një "letërsie kombëtare". Po të kuptosh "letërsinë kombëtare" si një shkollë, një program, një kanun, një dogmë që duhet të merret parasysh, të ndiqet patjetër nga shkrimtarët, ashtu siç ka qenë me "realizmin socialist", atëherë do të thosha se kjo do të ishte jo vetëm gabim, por bile shumë e rrezikshme. Katastrofë. Për mua, letërsia është një gjë krejtësisht individuale. T'i shërbejë kombit të vet, nuk është detyra e shkrimtarit. Në qoftë se ka dëshirë t'i shërbejë kombit, le ta bëjë, por kjo gjë nuk e bën veprën e tij më të vlefshme. Në qoftë se nuk ka interes t'i shërbejë kombit, prapë është në rregull dhe prapë nuk ka të bëjë me vlerën e veprës të tij.

Një tjetër gjerman, përkthyes i njohur, indjeri Joachim Lankch, është shprehur se: Përkthimin e letrave shqipe në gjermanisht e vështirëson një fakt i hidhur: me gjithë

trombetimin e medias shqiptare, letërsia albanofone pothuaj nuk njihet në vendet gjermanishtfolëse. Lexuesi, kritika, media kulturore këtej e njohin emrin dhe veprën e Ismail Kadaresë dhe jo letërsinë shqipe. Kjo, kuptohet, nuk është "faji" i shkrimtarit Kadare. Janë përkthyer edhe shkrimtarë të tjerë, mirëpo përkthimet e tyre mbeten nën hijen e veprës letrare të autorit më të përkthyer shqiptar... – a është e saktë, çfarë nuk shkon sot me ardhjen e letërsisë shqipe në botën gjermane?

Rrallëherë kam qenë i një mendimi me Lanksch-in dhe jo vetëm për shkak të qëndrimit të tij armiqësor ndaj Kadaresë. Mendimin e tij, të cilit i referoheni ju, e kam kundërshtuar që në konferencën e përkthyesve, të organizuar nga Ministria e Kulturës (në mos gaboj) në vitin 2002 në Shkodër. Këtë "teori" gjithmonë e kam konsideruar si përpjekje vetëjustifikimi, vetëshfajëzimi. Të fajësosh Ismailin për mospasë (e supozuar) e autorëve të tjerë shqiptarë në botën e jashtme, për shkak të hijes së tij super të rëndë, është – kërkoj falje për shprehjen – një idiotësi. Çfarë përgjegjësie ka Kadareja për, le t'i quajmë, ëndrrat e zhgënjyera të disa shkrimtarëve shqiptarë? Ç'mund të kishte bërë Kadareja për t'i ndihmuar kolegët gjoja të shtypur prej hijes së tij? Të thoshte "mea culpa", të flakte tutje stilolapsin dhe të shkonte në manastir, si murg i heshtur? Le t'i marrim si shembuj të tre viganët e letërsisë amerikano-veriore, William Faulkner, John Steinbeck dhe Ernest Hemingway. Të tre ishin bashkëkohës, të tre fituan çmimin Nobel. Po t'i besonim teorisë bizare që përmendet ju, një gjë e tillë s'do të kishte qenë e mundur.

Kadareja nuk ka penguar përhapjen e letërsisë shqiptare jashtë. Përkundrazi, pa të si "akullthyes", letërsia shqiptare do të ishte akoma më "e pasuksesshme", më "e panjohur" në botën e huaj. Cili shkrimtar tjetër shqiptar mund ta kishte zëvendësuar Ismailin në analet e letërsisë europiane? Kishte disa aspirantë, të respektuar si njerëz dhe si autorë. Bile jetonin jashtë Shqipërisë, në qendra të rëndësishme të jetës letrare botërore, afër shtëpive më të njohura botërore. Përkthyes kishin. Pse nuk fituan famën botërore të dëshiruar? Për faj të Kadaresë? Çfarë ka bërë ai për t'i penguar? Fakt është: të gjithë ata që mendojnë që është me vend të shash, të ofendosh dhe të fajësosh Kadarenë nëpër botë, i bëjnë një shërbim shumë të keq letërsisë shqiptare. Dhe Shqipërisë. Pra, në fund të fundit, vetes.

Në këtë kontekstualizim, si përkthyes i veprës së Ismail Kadaresë, për të cilin thonë se ishte akullthyes për letërsinë shqiptare, a keni një vështrim çfarë ka ndodhur pas tij me letërsinë shqipe, si shihet kjo në botën gjermane sot?


Me ose pa Kadarenë, në tregun e librit të botës gjermanishtfolëse letërsia shqiptare duhet t'i bëjë ballë konkurrencës së të gjitha letërsive të kësaj bote, nga Afganistani deri te Zelanda e Re (po të fusim Zvicrën në botën gjermanishtfolëse). Sipas të dhënave të OKB-së ka 193 shtete në këtë planet. Specialistët e gjuhësisë thonë se në vendet përkatëse fliten rreth 6.000 gjuhë. Me çdo respekt për prirjen e çdo populli për të konsideruar vendin e tij si boshtin e botës, besoj se kam të drejtë të them se shqiptarët, në relacion me numrin e popullsisë dhe fuqinë e ekonomisë të vendit të tyre, nuk janë përfaqësuar keq në arenën e letërsisë ndërkombëtare.

Rezultatit e letërsisë shqiptare, që ajo të jetë në nivelin e duhur, e keni lidhur me botuesit, duke u shprehur se këtu ka pronarë shtypshkronje që fitojnë duke marrë para nga autorët. Besojmë se flisni nga një përvojë europiane, çfarë mendoni se është pengesa kryesore këtu, për letërsinë shqipe, që ajo të zhvillohet?

Nuk dua të ofendoj botuesit shqiptarë, disa nga ata i konsideroj miq. Gjithashtu, besoj se në vitet e fundit në punën e tyre ka pasur përmirësime. Por vazhdoj të mbroj idenë se sistemi shqiptar i botimeve duhet të përmirësohet akoma më shumë.

1. Praktika për të botuar çdo gjë që u afrohet, kundrejt pagesës nga ana e autorit, është shumë e dëmshme për gjithë letërsinë shqiptare, sepse mosndarja e profesionistëve nga amatorët sjell një ulje të përgjithshme të nivelit cilësor.

2. Botuesit nuk duhet të botojnë librat që u ofrohen, por duhet t'i përzgjedhin vetë, sipas kriterit të cilësisë. Sipas parimeve të ekonomisë së tregut, hedhja e librave



me cilësi të lartë garanton sukses në treg. Libra të dobët nuk shiten. Dhe shumica absolute e librave të vetëfinancuar nga autorët janë të dobët. Përfundojnë duke u pluhurosuar në raftet e librarive.

3. Ku drejtuesit e shtëpive botuese janë në radhë të parë biznesmenë dhe jo specialistë të letërsisë, duhet të marrin në punë specialistë të tillë, për të siguruar që përzgjedhja e autorëve të bëhet sipas kriterit cilësor.

4. Botuesit duhet të kujdesen për autorët e tyre, sikur t'i kishin fëmijë, se ata janë baza e suksesit (dhe në fund të fundit të të ardhurave) të shtëpisë botuese. S'mund të financosh programe me botime cilësore me lekët e autorëve vetëbotues.

5. Sistemi i shpërndarjes së librave duhet të përmirësohet. Turmat e lexuesve në sallat e Panairit të Librit në Tiranë tregojnë se në vend ka interes për krijimtarinë letrare. Por nuk ka një numër të mjaftueshëm të librarive, sidomos "nëpër rrethe".

5. Në një vend kur shkrimtarët e kanë zor të gjejnë një agjent letrar që rregullon marrëdhëniet e tyre me botuesit jashtë, kjo detyrë u bie botuesve vendas: ata duhet të shfrytëzojnë kontaktet e tyre të dendura (vetëm teori, këtë e di fare mirë!) me kolegët jashtë, për të promovuar veprat e autorëve të rregullt të shtëpisë botuese që drejtojnë.

6. Botuesit shqiptarë duhet të botojnë autorët më të rëndësishëm të letërsisë botërore jo sipas rastit ose sipas qejfit të përkthyesit, por në mënyrë sistematike, duke garantuar përkthime cilësore. Çdo shtëpi botuese duhet të ketë jo vetëm autorë të rregullt nga vendi, por edhe autorë të rregullt të letërsisë ndërkombëtare. Unë jam plotësisht i vetëdijshëm se propozimet e sipërme do të konsiderohen si trille të një ëndërrimtar kokëfortë, por ne jse. Ashtu punojnë shtëpitë e suksesshme botuese nëpër botë.

Mbi ç'kriteret e bëni përzgjedhjen e një libri për ta përkthyer?

Nuk i përzgjedh unë librat për përkthim, i përzgjedhin botuesit. Unë mund të bëj propozime. Pa porosi nga ana e shtëpisë botuese që ka marrë përsipër botimin nuk filloj të punoj, sepse ajo, shtëpia botuese, më paguan. Dhe aq ëndërrimtar kokëfortë (shih lart) nuk jam që punoj pa u paguar. Me idealizëm, pasion, miqësi nuk mund të mbushësh barkun. Jam me profesion të lirë, nuk mund të ofroj idealizmin tim falas duke mbajtur familjen time me një punë tjetër, të mirëpaguar. Pra, unë punoj vetëm me kontratë përkthimi. Thashë, propozime mund të bëj. Ndërkëshillohem me botuesin për përzgjedhjen e tekstit të ardhshëm, siç e bëjmë në rastin e Kadaresë. Ka shumë gjasa që do të pranohet ofertën e një botuesi kur më pëlqen libri. Ka gjasa që do të pranohet ofertën e një botuesi edhe kur s'më pëlqen libri, sepse më duhen lekët. Unë refuzoj repretësisht të përkthej libra me përmbajtje raciste, ekstremiste,

totalitare, antihumanitare, seksiste, fyese etj. Unë kurrë nuk punoj për individë (d.m.th. autorë). Nuk punoj për "shtëpi botuese vetëpaguese". Kaq.

Ju keni përkthyer, gjithashtu, edhe veprat e disa autorëve nga Kosova, siç janë Anton Pashku, Mirko Gashi dhe Rexhep Qosja. Në intervistë për Radio Kosovën keni thënë se jo çdo libër që është me rëndësi për vendin e vet, është me rëndësi edhe për botën e jashtme... çfarë kishit parasysh me këtë?

Që shumica e librave të botuar në këtë planet nuk kanë të njëjtën rëndësi në vendin e origjinës dhe në botën e jashtme, është arsyeja kryesore që vetëm pak arrijnë të kapërcejnë kufijtë shtetërorë. Kjo vlen për çdo vend, jo vetëm për Kosovën ose Shqipërinë.

Disa autorë nga Kosova i kam përkthyer me entuziazëm. Mirko Gashi dhe Ali Podrimja kanë qenë poetë të mrekullueshëm. Romani "Vdekja më vjen prej syve të tillë" i Rexhep Qosjes është një kryevepër e letërsisë shqipe. Anton Pashku ka qenë një shkrimtar mjaft interesant që, fatkeqësisht, nuk njihet shumë në Shqipëri, por që ka lënë gjurmë të thella në letërsinë kosovare. Kam përkthyer edhe autorë të tjerë kosovarë, disa me dhe disa pa qejf. Pyetja e logjikshme në këtë kontekst do të ishte: Si e vlerësoni ju letërsinë kosovare? Do t'i përgjigjem edhe pyetjes së pabërë. Në socializmin më liberal të ish-Jugosllavisë, autorët shqiptarë në Kosovë kishin më shumë mundësi për t'u njohur me letërsinë botërore, nuk i ishin nënshtruar dogmës së realizmit socialist, prandaj letërsia shqipe atje ka marrë një zhvillim tjetër nga letërsia në Shqipërinë e mbyllur. Rrymat moderne dhe postmoderne kanë hyrë më shpejt dhe janë përqaftuar nga autorët. Me gjithë ndryshimet që kanë ndodhur ndërkohë në Ballkan, të dyja letërsitë nuk kanë gjetur akoma rrugën për t'iu afruar njëra-tjetrës. Fatkeqësisht. Është diçka që nuk mund të shpjegohet lehtë.

Marrëdhëniet me Shqipërinë i kam shumë më të ngushta sesa marrëdhëniet me Kosovën, për arsye historiko-personale. (Me njerëzit, individët kosovarë, kam zhvilluar marrëdhënie, i kam përkthyer në mijëra gjyqe për azil. Njoh edhe disa intelektualë.) Shteti i pavarur i Kosovës nuk më ka zgjatur dorën. Nuk ka për detyrë të bëjë një gjë të tillë, nuk ankohem. Vetëm desha të them se nuk kam pasur mundësi të njihem nga afër me Kosovën. Me Shqipërinë kam marrëdhënie të vjetra, të qëndrueshme, letrare dhe jashtëletrare, ndërkohë edhe familjare. Është një pjesë e pandashme e jetës sime, me ose pa shtet.

Pas gjithë kësaj bisede, mendoj të vështirë për ju (?), për t'i dhënë vlerën që i takon letërsisë së një gjuhe, keni një qasje se ç'prespektivë mund të ndjekë, keni autorë që vlerësoni e që do t'ia sugjeroni me bindje botuesit gjerman nga shqipja?

Kjo pyetje ishte e pashmangshme. Por unë mund t'i shmangem përgjigjes. Unë nuk jam profet. As mësuesi i shkrimtarëve shqiptarë. Ka autorë që i vlerësoj dhe ka edhe autorë që s'i vlerësoj, por nuk dua të përmend emra, ngaqë, sipas përvojës sime, kjo nuk do të sillte asgjë të mirë.

Mirëpo, për një gjë, një përshtypje, nuk dua të hesht: më duket se letërsia shqipe gjendet në një fazë amullie. Aktiviteti letrar i shkrimtarëve të moshës së mesme është në ulje, merren më shumë me punë të tjera. Më të vjetrit besoj se nuk do t'ia japin letërsisë shqipe impulse freskuese. Ku janë shkrimtarët e rinj? Libra ka mjaft, edhe libërshkrues, politikanë, "analistë", gazetarë, "vip-a", shkruar vetëbotues, por jo tamam shkrimtarë me prespektivë. Shpresoj të gaboj.

Më lejoni disa fjalë të fundit. Ju më keni bërë pyetje shqiptare dhe unë ju kam dhënë përgjigje gjermane. Jam i vetëdijshëm se kanë potencialin të shkaktojnë një valë të re indijimi ndaj meje. Por ky s'është faji im. Çdo gjë mund të lexohet në (të paktën) dy mënyra. Qëllimet e mia nuk janë negative. Bile kuptoj deri në njëfarë mase "shqiptaroqëndrizarmin" që është arsyeja se nga i huaji që do të konsiderohet si dashamirës i Shqipërisë, pritët që të bie dakord me pak a shumë çdo gjë që vjen nga Shqipëria. Por kam dyshim se një qëndrim i tillë mund të jetë i dobishëm.

Në fund të fundit, mund të thuhet se unë jam një përfaqësues tipik i kësaj Europe që do të mirën e Shqipërisë, por neverit shumëkënd në Shqipëri me sjelljen e saj jo shumë të kujdesshme, direkte.

E NJERËZISHMJA NË POETIKËN E SIMON VRUSHOS

nga Namir Lapardhaja

Në ciklin poetik “Asnjë fill i gjelbër”, Simon Vrusho rishfaqet pas një pauze të gjatë si levrues i poezisë, duke shpalosur botëkuptimin e tij për këtë zhanër.

Rikthimi është jo i lehtë. Kohët janë të vështira dhe uni lirik nuk sheh asnjë fill të gjelbër, nuk sheh rrugëdalje dhe dritë në errësirën e himnit të hungërimave.

*“Jam këtu në mes të pyllit/
Ku nuk shihet asnjë fill i gjelbër/
Himni i hungërimave ka rënë në koma/
Nën një qiell të hapur jashtë/
Mjerë ju, o kafshë!”*

Simoni si njeri ishte sqimatar. Këtë karakteristikë e mishëron më së pari poezia e tij. Frazja e sendërtuar me elegancë dhe rregullsi e vargëzimit të bien në sy. E bukura si kategori estetike shënjonte gjithçka që kishte të bënte me shkrimtarinë e poetit, duke filluar nga një koment i çfarëdoshëm në rrjetet sociale e deri te krijimet e mirëfillta artistike.

*“Nuk të del kurrë e keqja në rrugë/
kur rruga është e keqja vetë”,
- shkruan Vrusho. Ose:
“Kur poshtërsia ngjitet lart/
Malet shkundin shifërën e lartësive në harta.”*

Ai shfaqet përgëzues dhe urues në vargjet e tij. Një gjë e tillë del në poezinë “Urim për filizin”, ku “filizit” i dëshirohet që në rritje ta shohë botën nga sytë e një peme. Në fakt, nuk është gjë tjetër vetëm se një metaforë e mrekullueshme për njeriun, i cili duhet të tejkalojë vetveten dhe të mos ngelet i vogël:

“Rritu filiz,/
I brishtë, i hollë, i lehtë si një gjethe./
*Kur të rritesh, mos harro/
Ta shohësh botën me sytë e një peme.”*

Vrusho krijues nuk besonte te letërsia “në vete e për vete”, por ai e shihte krijimtarinë të lidhur me mesazhin poetik, me jetën dhe realitetin e përditshëm. Disa prej poezive të tij duken të tejkaluara në këtë drejtim, mirëpo ato janë moderne për sa i përket larmishmërisë së gjuhës, figuracionit të pasur, ritmit, muzikalitetit të vargut dhe të strofës.

Poezia “Harrim” është shprehje e një lakonizmi të thellë, gjuhe të pasur dhe ritmi të shpejtë, që krijon një muzikalitet gjatë gjithë vargjeve:

*“Pasi u artikuluan me radhë vendimet/
Për të parin, të dytin, të tretin... të tridhjetë e nëntin/
I njëqindi nuk e dëgjoi të tijin dënim.../
Zoti gjykatës, ku e latë dënimin tim?/
Po, ti je dënuar me harrim...”*

Në krijimtarinë e tij Simoni shpërfaq përbrendësinë e prejardhjes dhe të vendlindjes. Velçani, fshati ku lindi dhe kaloi fëmijërinë, është një lloj Makondoje markeziane, ku bota aty jo vetëm zë fill, por gjithçka “gatuhet” me baltën, ëndrrat, gojëdhënat, rrëfimet dhe rrëfenjat e vendlindjes.

Poezia “Për ku jeni nisur të paudhë?” me motive folklorike, i përngjet një valleje të ngjashme me valët e detit, alla-lasgushiane:

*“Për ku jeni nisur të paudhë?/
Më kot tani hiqni frymën thellë,
Mallkimi pas ju ndjek – gunë e zezë/
Dhe më s’ju qas tani asnjë shpellë./
Për ku jeni nisur të paudhë?/
O të paudhë të mëdhenj!/
Kur s’ka faltore për ju kurrkund/
Si mund të ketë një Shëmbërdhenj?!”*

Vrusho është shpotitës në lirikën e tij. Është i pakompromis me të keqen, e lufton atë dhe duket sikur shtron shinat e një rruge vetjake që udhëhiqet nga e bukura dhe sublimja.

Në poezinë “Ejani”, e ndërtuar mbi bazën e një kontrasti të thellë, poeti shndërrohet në misionar të shpirtit njerëzor, duke e shpëtuar atë nga shuarja:

*“33 lisa mbledhur mbi një degë,
Mbështetur në të dhe shtëpia ime./
Dëborë dhe shqotë/
Dhe një diell i hollë në dimrime./
Dhe rrënjët tok me limfën ngjisin lart/
Një shkëmb ku platitet çdo erë,
Ejani, ndizni këtu një qiri/
Që shpirti mos t’ju shuhet, o të mjerë.”*

Simoni është mjeshtër i gjuhës dhe artizan i fjalës. Ai luan me fjalën në ndërtimin e vargut ngjashëm si gurskalitësi me gurin e tij për ndërtimin e një kalldrëmi.

Poezia e tij “Vesë dhe Brymë” ka karakteristikë të mirëfillta tregimtare. Lexuesi duket sikur po lexon një prozë poetike të Martin Camaj, ku disa elemente të thjeshta të agimit të ditës arrijnë të na japin poetikisht kuptime të thella jetësore:



*“Pllajë.../
Ku janë këtu varret e këmborëve?/
Brinjë.../
Ku janë këtu varret e zileve?/
Një vesë e hajthme, e trishtuar/
Ka rënë nga yjet si përshpirtje.../
Dhe fryn një erë,
Bie një fyell në një degë lisi.../
Ku je o mali ynë?/
Bari ngjethet,
Vesa-mornica/
Kthehet sakaq në brymë...”*

Ironia deri në sarkazëm është një armë e fortë e poetikës së tij. Ai kritikon, por nuk tallet, ironizon, por nuk anatemon, mban qëndrim, por nuk përbaltë. Në poezinë “Delirius” ironia duket se arrin shkallën më të lartë, duke e shpirtëzuar delirin si humbje e vetëdijes dhe funksioneve njohëse për një periudhë të shkurtër kohore, e duke i dhënë atij tipare dhe karakteristika njerëzore, madje edhe duke e emëruar:

*“Të hipën në skenë dhe të thanë: Luaj!
Teatër, teatër, teatër/
Skenë, skenë, skenë/
Kanë kaluar vite dhe teatri ende s’ka një emër!
I veshur me djersë si me lotë/
Ti nis monologun: – Një emër, ju lus!
Pas vdekjes nominohesh: DELIRIUS”*

Simoni e tejlakon ironinë duke shkuar deri në autoironi si shkalla më e lartë e saj. “Midis tinëzarëve/ naiv kam qenë...” – shprehet ai në një varg. Ndërsa më tej nëpërmjet dy krahasimeve poeti i bën të qartë lexuesit se çfarë ka qenë ky “naivitete”:

*“...Si dëbora/
Si një kristal i butë në ajër/
Goditur jo befás nga krabu i një zogui/
Që ia ndryshon trajektoren!/
Dhe që atëherë mbeta/
në familjen e ortekëve.”*

Poezika e Vrushos ka karakteristikë që shprehin përbrendësinë intelektuale të poetit:

*“Sipas Nerudës duhet të thosha/
Se ata janë një tufë minjesh/
Që kanë hipur mbi supet e popullit/
dhe që aty ia brejnë/
Të gjithë flamujt e parimeve të shenjtë”*

Në këto vargje ai mbështetet tek poetë të tjerë për të kuptuar realitetin jetësor të përditshmërisë së tij, njëkohësisht ato tregojnë njohjen e thellë që ka ndaj letërsisë së mirë.

Po ashtu, në poezinë “Filozofi”, veçse këtë radhë burimi është një plak që është shndërruar në filozof, i ngjashëm me filozofinë e Lindjes së largët:

*“Dhe më ka thënë dikur një plak:/
Trokitjet e hapave në tokë,
Trokitje të lehta,
Por pyetja është e rëndë:
Jemi ne që trokasim në tokë/
Apo toka që troket në ne?”*

Vrusho poet është i ngjashëm me Simonin njeri. Kjo, në dallim nga shumë poetë të tjerë. Është njeriu që beson tek arti poetik si përbrendësi e tij dhe tek aftësia që poezia ka jo vetëm për të kritikuar dhe nxjerr në pah, por, mbi të gjitha, për ta kuruar qenien njerëzore. Ai beson në ato që shkruan dhe shkruan vetëm ato që beson.

Në përmblyllje të kësaj analize të shkurtër tekstuale të disa prej poezive të Simon Vrushos, më vjen ndër mend vargu i sivëllait të tij poet, Ndoc Gjetja, që kumpton: “I dekoruar Njeri qysh në ditën e lindjes nga Nëna”.

Dhe ky është përkufizimi më i drejtë për të si krijesë dhe krijues: Simoni ishte dekoruar “Njeri” qysh në lindje. Dhe sa nevojë kemi sot pikërisht për Njeriun....!

FUNDI I TË FUNDMES SHPRESË

tregim nga Safet Sadiku

Ti nuk je atje ku duhej të ishe dhe ku do të të pëlqente të ishe. Duhej dhe të pëlqente! Sa pranë këto dëshira, por sa largojnë kur mes tyre hyn koha! Gjithmonë në pritje të një çasti më të volitshëm dhe gjithnjë çastet ktheheshin në muajt e muajt në vite deri sa vjen një ditë e ti ndalesh për ti hedhur një vështrim rrugës së përshkuar. Sheh atje vetëm dashuriçka, endje pas së bukurës në libra e më pak në jetë dhe gjithnjë e më shumë dëshira të pa realizuara e më pak shpresa për t'i realizuar. Një dështim i plotë i një jete të tërë.

Mbase jo i tërë viteve. Kohë më parë i pate lejuar vetes edhe ndonjë shkarje drejt dashurisë. Aty-këtu ndonjë vajzë e pati thyer monotoninë në murgerinë tënde. Dhe, për dreq, imazhi i tyre të pati ndjekur pas për një kohe të gjatë. Por ti ia kishe dalë për ta shuar këtë imazh. Në to ti nuk e kishe gjetur të bukurën, dashurinë, gjithnjë sipas peshores tënde. Thellë-thellë në vetdije e kuptoje se vetëm në këto vite kishe jetuar, ndaj dhe jo rastësisht mundoheshe ti përsërisje ato.

A të kujtohet ajo ditë kur për herë të parë një fëmijë të thirri "xhaxho" dhe pasqyra në dhomë të zbuloi një tabor të tërë thinjash? Atëherë u binde se vitet nuk të qenë shënuar vetëm në pasaportë. Pas kësaj përherë e më shumë jehonin në veshët e tu thirrje të tilla, bile akoma më të avancuar "plaku", "i moshuari". Të qetësonte vetëm fakti se ndryshime të tilla ende nuk kishin ndodhur në shpirtin tënd. Po aq përvëlues të kishte mbetur atje zjarri që ndiznin librat dhe projektet letrare. Ah, të mos kishte qenë kjo plaga e fundit në zemër, ndoshta flokët do të të ishin nxirë sërish, rudhat do të qenë rrafshuar e askush nuk do të guxonte më të thoshte: "Ai plaku" Por ja që asgjë nuk mund të kthehet më prapa! Sidoqoftë ndjenja jote ndaj së bukurës vazhdon të të ngacmojë si dhe më parë. Në fakt, ajo të ka ndjekur gjithnjë pas. Mbase qe pikërisht kjo ndenjë që ta bëri të magjishme figurën e vogël të asaj brunes nga pallati përkarshi kur të trokiti në derë këtu e ca vjet më parë dhe kërkoi me drojë nga xhaxhi Agron t'i zhvillojë tre nga temat e mundshme të hartimit. E si mund t'ia refuzojë këtë kërkesë brishtësisë që të qëndronte përpara! Diçka nga "Komedia Hyjnore", (të kujtohet), u shtjellua me aq pasion, sepse pasionante qe edhe dashuria e Francesca da Riminit ndaj Paolo Malatestes. Vajza kërkoi të dinte diçka më tepër rreth kësaj dashurie me fund tragjik në të dy jetët, ku vendin e arsyes e kishte zënë stuhia e ndenjave, një stuhi që edhe në botën e përtejme nuk arrin t'i ndajë nga njëri-tjetri. Klodiana ishte vetëm tetëmbdhjetë vjeç dhe në gojën e saj është e natyrshme pyetja nëse egzistojnë në jetën reale stuhi të tilla dhe a njohin kufi moshe ato. Ti e shfrytëzoje këtë rast për t'i shfletuar faqe të tëra nga dashuria e Mazepës për Marian, e Khanit për robinjën e plotë e plotë raste të ngjashme që e trallisnin Klodianën. Ditë më pas vajza kërkoi t'i lexonte të plota këto dashuri dhe ti i vure

në dispozicion bibliotekën tënde të pasur. Tashmë nuk janë vetëm hartimet që e afrojnë Klodianën tek ty. Zelli i saj për të depërtuar në thesarët e letërsisë botërore duhet ushqyer. Dhe ti tregohesh i gatshëm për ta bërë këtë. Vajza përpin vargje të Safos, Anakreonit, Tibulit. Një ndalesë e shkurtër tek "Metamorfozat" për të njohur nga afër Narçizin e, pastaj, për të rendur tek kolosi i vargut, Bajroni. Askush nuk mund ta përshkruante kënaqësinë tënde tek shihje se si magjepsesh vajza nga himni i poetit për oqeanin, që shkatërronte qindra dashuri e lindëte mijëra të reja. Dhe, me zemrën zjarr, shihje se si në vështrimin e saj të ndezur shpërthenin stuhi ndjenjash që herë – herë, të trembnin me uturimën e tyre. Nuk di se si njëherë e quajte Irenë dhe vajza këmbënguli të njihej me te. Pas leximit të "Sagës së Forsajteve", ajo, me të qeshur, të quajti ty plaku Xholion. Vetëm atëherë kuptove se kishte hedhur një hap të guximshëm tej kufinjëve që të lejoheshin. Por tani ishte vonë për t'u tërhequr. Marrëzia e saj të kishte pushtuar edhe ty. Ndaj s'të befasoi dëshira e saj që, ashtu si Migeni tek "Lulet e Mollës", të varrosej në një udhëkryq në rast zhgënjimi nga dashuria e parë. Po cila qe dashuria e saj e parë? Duke e mbajtur gjithë kohën e lirë pranë vetes, ti i kishe hequr asaj çdo mundësi për të hyrë në jetën reale, mes moshatarësh, në hullinë e aventurave të pafajshme rinore. Ç'që ajo ndjenjë xhelozie që të gllabëroi të tërin e të la shumë netë pa gjumë kur vure re njëherë, rastësisht, Klodianën të shoqëruar me një djalë. Bëre çmos për t'ia shkurtuar edhe me kohën e lirë, duke e kredhur të tërën në botën magjike të librave. Dhe ajo, krejt e padjallëzuar, e pranoi me endje këtë magjepsje. Dhe, duke e parë atë me libra në duar, pyesja veten i shqetësuar: "Ajo tashmë është njëzet vjeç. A do të jetë cenuar zemra e saj nga dashuria? Nëse po, a do të jetë i denjë ai djalë për këtë thesar? Ç' vend zë unë në këtë zemër dhe a e meritoj atë?" E solli rasti që tragjedia "Othello" të binte në dorë të lexueses së pangopur. Dhe, pas leximit, pyetja: "A ka xhelozie kaq të fuqishme sa ta kthejë një dashurues në vrasës?".

E si mund t'i përgjigjeshe ti një pyetjeje të tillë? Xhelozia për ty, deri para pak kohë, qe e panjohur. Po tani kanë të bëjnë me xhelozinë ato shqetësime të fshehta që herë pas here t'a trazojnë gjumin? Nëse ato janë shenja xhelozie, a do të mundeshe ti të vrisje dikë i shtyrë prej saj? Po Klodiana a priresh nga një ndjenjë e tillë makabre? E le për më vonë përgjigjen që të kërkonte vajza.

Për më vonë le edhe shumë gjëra të tjera. Ashtu si gjithnjë.

Ndërsa koha ecën, thinjat shumohen, rudhat në fytyrë thellohen. Kjo nuk ndodh me Klodianën. Ajo vazhdon të lulëzojë përherë e më shumë. Tashmë është bërë kolegja jote dhe jep mësim në të njëjtën shkollë. Biblioteka jote tashmë është e varfër për të nginjur

pangopsinë e Klodianës. Ajo kërkon gjithnjë e më shumë, tashmë nga ty. Vështrimi i saj është mësuar tashmë dhe nuk i bëjnë më përshtypje rudhat e thinjat e tua. Ajo që i bën më shumë përshtypje tani është bota jote e brëndshme. Ajo gjen të reflektuara atje ato shqetësime që ia kufizojnë paksa horizontin e së nesërme.

Ti e njeh burimin e këtyre shqetësimeve, por kupton edhe paaftësinë tënde për t'i fashitur ato. E ç'mund t'i japësh ti asaj? Vjetë, qe të kanë mbetur aq pak? Kurajo e guxim, që ti asnjëherë nuk i ke pasur të mjaftueshëm? Gëzimin e pafre, varicione që ndjekin njëri-tjetrin, dëshirën për ta pasur gjithë botën tënde? Edhe këtu nuk je shquar për tepri.

Vajza nuk kërkon më subjekte dashurie, por vetë dashurinë. Ç'po ndodh kështu me ty? A nuk ishe ti që rendje si i marrë mes mijëra titujsh e faqesh në kërkim të asaj bote të bukur, që në jetën e përditshme të qe fshehur, në kërkim të asaj dashurie të pashuar që nuk e ndeshje askund përreth, në kërkim të atij pasioni që do të të përvëlonte për aq e aq vite? Po a nuk është kjo krijesë hyjnore që t'i jep të gjitha këto pa kursim dhe për aq kohë sa ti ta ndjesh vetën të nginjur për herë të parë në jetën tënde? Çfarë i ke kërkuar jetës më shumë se kaq?

Po ajo çfarë i kërkonte jetës?

Duke marrë pjesë në formimin e botës së saj të bredshme (ti duhet ta dish këtë) gjatë gjithë kohës ti e tërhoqe atë pak e nga pak në thellësi gjithnjë e më të mëdha të botës së librave. Sepse diku aty e kishte kërkuar edhe ti rrugën për në jetë. Dhe jo se dole i zhgënjyer, por me një uri më të madhe nga çpate më parë. Kjo përvojë duhej të të kishte frenuar për të tërhequr për atje edhe Klodianën. Dy shpirtëra të uritur nuk mund ta nginjin njëri – tjetrin. Është pikërisht kjo që të tremb tashmë ty. Ti edhe sot e kësaj dite vazhdon të rëmosh rafteve të bibliotekave, gjithnjë në kërkim të asaj që nuk e di e që ende nuk e ke ndier. Një sëmundje kjo të cilën nuk do ta këmbëje me asgjë më të mirë në botë.

Pa dyshim, edhe ajo kërkon, ashtu si ti gjithnjë e më shumë copëza jete, vetë jetën, atë që e rrethon dhe atë që ende nuk e njeh. Ajo ka shumë vite përpara, ka përpara një jete të tërë. Goxha kohë për t'i vjelë jetës shumë më tepër se ç'i vole ti. Dhe do të vijë një kohë që ti do të kesh shtrëtur, ndërsa ajo do të mbart një bagazh tepër të rëndë për supet e tua të ronitura. Dhe befas vështrimi i saj do të rreshqasë jo pa indiferencë në shogësinë e kokës tënde, në thellësinë e brazdave të fytyrës tënde. Pamje jo fort e bukur për sytë e një riosheje. Nuk mund të mos e parashikoje këtë fakt.

Ngjarjet rrodhën në një drejtim të papritur për ty. Nuk e prisje aq shpejt atë puthje të parë një pasdite pranverore, kur diskutonit mbi pavdekësinë. Ti ngulje këmbë se të pavdekshëm mbeten gjenitë, ata që kryejnë vepra madhore në shërbim të njerëzimit. Atëhere unë jam një pjestare e këtij njerëzimi dhe bëre një punë kolosale për formimin tim, ndaj për mua mbetesh i pavdekshëm, thoshte vajza. Dhe, ndërsa ti bëheshe gati ta kundërshtojë, ajo të hodhi duart në qafë dhe të zgjati buzët. Një puthje përvërluese që zgjati pambarimisht. Një puthje pas së cilës ti e ndjeve frikën të të pushtonte me tërë lakuriqsinë e saj. Thellë thellë ti e prisje këtë, sepse tërë ato vite këtu të çonin. Por tridhjetë vjetët që të ndanin prej saj qenë një humnerë e frikshme së cilës i trembeshe. Veçse nuk gjeje kurajo edhe për të refuzuar. A duhesh refuzuar kjo dashuri e parë e Klodianës, nga ajo nuk shihje dhe gjykonte, por vetëm ndjente? Një ndjenjë e pastër që ti nuk e meritoje. Sepse ishte shumë e vonuar. Herë - herë edhe kishte çukatur në zemrën e ndonjë vajze vite më parë, por ishte tërhequr pa e vrarë mendjen për pasojat që mbetëshin pas. Mbase nuk është vonë për tu ndërgjegjësuar se nuk duhen lënë me pasoja të tilla. Në ballancë vihesh vrasja e një dashurie dhe shpëtimi i një jete. Midis këtyre dy të këqieve ti zgjodhe më të voglen, ndaj dhe sonte nuk je atje ku duhej të ishe dhe ku do të të pëlqente të ishe. Mes zhgënjimit dhe lotëve të vajzës dhe murgërisë, zgjodhe këtë të fundit, më të keqën për ty, zgjodhe fundin e të fundmes shpresë.

UJI, E GJITHË PESHA E TIJ

tregim nga **Roxane Gay**

Uji dhe dëmi prej tij nuk i ndaheshin Biankës. Kurdo që ngrinte sytë lart, kudo që ngrinte sytë lart, njollat e ujit shfaqeshin në formën e vijave të errëta që dredhojnë nëpër suvanë e thatë të murit për tek paretet prej fibre, duke i mbushur me ndryshk dhe figurina. Pika të mëdha uji binin mbi llërët, ballin dhe buzët e saj.

Në palestër, një nga paretet prej fibre mbi shtangat e vjetra më në fund ishte thyer. Pluhuri i shpërndarë kishte formuar një pirg mbi dysheme. Aty ndodhej një shkallë dhe poshtë hapësirës së zbrazët ishte një kuti e hapur veglash. Asnjë mirëmbajtës s'dukej gjëkund. Ajo nisi rutinën e zakonshme të gjimnastikës, duke filluar me vrapin në palestër. Ndjeu si iu shkrifëruan muskujt dhe kockat e trupit ndërsa gjeti ritmin e duhur të ecjes. Një pikë uji i lagu qafën, pastaj një tjetër. Ngriti sytë lart, mbajti hapin. Një njollë e re u përhap ngadalë përgjatë paretit. Vazhdoi të vraponte.

Më vonë, në punë, Bianka u ul në tryezën e punës dhe hëngri një drekë normale: sanduiç me mustardë, marule dhe domate. Sipër saj, paretet e tavanit ishin kalbur qëkuri duke marrë ngjyrë të errët dhe të padallueshme. Zyra e vogël ishte mbushur me kundërmim lagështire që i ngitej rrobave të saj për orë të tëra çdo natë pas pune. Për fat të mirë, Bianka ishte shumë e zonja në punën e saj. Ajo punonte me kompetencë. Punonte shpejt. Ishte e pashme dhe më një pamje të ëmbël. Pasi hëngri sanduiçin, fshiu thërrimet me duar dhe u kthye me pamje nga ekrani i kompjuterit. Bianka shtypi e shtypi tastat, gishtërinjtë i punonin shpejt. E shpërfilli fotografinë e ish-burrit të vendosur në cep të tryezës së punës. Mund ta kishte hequr prej andej muaj më parë por s'ishte e lehtë të zhdukej prej aty pa një pa dy.

Për muajin e mjalitit shkuan në shkretëtirën e Saharasë, për të bërë diçka ndryshe. Bianka tha më pas se Deni, tashmë ish-bashkëshorti, e kishte pyetur se çfarë kuptimi kishte të shkonin në fund të botës. Fshat më fshat, fëmijë që kërcenin nga gëzimi rendnin t'i përsëhendesnin, ndërsa zgjatnin duart nëpër shiun që kishte nisur të binte papandehur. Njerëz me ngrirë, me dhëmbë shumë të bardhë, krijonin një rreth që ngushtohej rrotull Biankës. Ata i lyejnë fytyrën, e ngrinin lart duke e mbajtur mbi shpatulla. Thonin se ajo ishte një zot. Kur u largua, ata u mbytnë nga dëshpërimi. Pastaj shiu pushoi dhe Deni me Biankën kishin ikur dhe filluan jetët e tyre si çift i martuar.

Ndërsa po ktheheshin me makinë në shtëpi, Bianka hapi pjesën e sipërme të makinës, që të hynin rrezet e diellit. Pasi u rregullua brenda në makinë, hodhi vështrimin drejt qiellit duke parë me zemërim retë që grumbulloheshin njëra pas tjetrës duke e vrenjtur motin. Për darkë hëngri makarona me pak gjalpë dhe djathë duke i shoqëruar me verë të kuqe. Sipër saj, taveri rënkonte, i enjtur me peshën e ujit. Kishte netë që rrinte e shtrirë në divan me sytë e ngulur lart, duke qëmtuar me imtësi pikat ku bashkoheshin njollat e ujit, formën e re që po merrte taveri, mënyrën se si paretet bënin bark kur fqinjët kalonin nga njëra dhomë në tjetrën. Kur lodhej, zvarritej në shtratin e saj të zbrazët, shtrihej në anën ku zakonisht flinte, duke këqyrur gjurmët e mezidukshme të trupit të ish-bashkëshortit që flinte dikur në anën tjetër të shtratit. "Kjo është jeta ime," tha ajo në dhomën e zbrazët. "Por jam mirënjohëse për atë që kam."

Më pas u përpoq të kishte besim tek jeta. Deni

s'e duronte dot faktin që kudo që shkonte Bianka, e ndiqte nga pas dëmi që shkakonte kalbëzimi i banesës nga uji. Ishte kaluar çdo lloj caku, uji që pikonte, mjedisi që po shpërbëhej nga kalbja kudo. Gjatë natës së fundit që kaluan së bashku, bënë dashuri, Deni u shtri në shpinë dhe po mbante të pasmet e Biankës me duar, duke shijuar mënyrën se si trupi i saj harkohej ndërsa përplasej me të dhe lëshoi një rënkim të butë teksa ai i tha "të dua" për herë të fundit. Ai hapi befasi sytë dhe treti vështrimin përtej gruas së tij të dashur, përtej barkut të saj të rrafshët dhe harkimin që ngrihej butësisht tek gjinjte, përtej edhe flokëve të saj të ndritshëm që i jepnin formë fytyrës, në errësirën që po kalbej mbi to. Palloshi iu squll aty për aty. Ndjeu që gjithë fuqia që kishte patur avulloi nëpërmjet poreve të trupit. Bianka rënkoi më shumë, reshti lëvizjet, duke ia ngulur thonjtë në krahë. "Çfarë ndodhi?" pyeti ajo. E puthi në mjekër, e kafshoi me dhëmbë buzën e tij të poshtme, e gudulisi në qafë. Ai e shtyu tutje. Megjithëse nuk kishte pikë fuqie, s'u tregua aspak i butë. Ajo ra mbi dyshemenë e lagësht.

Të nesërmen në mëngjes, Deni kishte ikur. S'mori agjë me vete përveç sporeve të pluhurit që i rriteshin në mushkëri. Nëse do të ishte nga tipat që qajnë, Bianka do ta pranonte se i kishte marrë me vete edhe zemrën.

Kur Bianka bëri tri ditë që ishte lindur, e ëma vuri re një njollë të vogël uji në qoshe të dhomës së fëmijës, mu mbi krevatin e fëmijës. Ajo s'i kushtoi fare rëndësi. Rroku në krah vogëlushen e saj të bukur me flokët e zezë drizë dhe sytë ngjyrë blu e thellë, duke e kolovitur sa andej-këndej, duke kënduar këngë pa kuptim. Ia puthi kokën e butë dhe mori frymë thellë për të ndjerë aromën dehëse të vogëlushes.

Ditë pas dite, ndërsa Bianka rritej, njolla e ujit bëhej më e madhe, derisa e gërreu të gjithë tavanin duke formuar një mozaik mural pluhuri të pistë. Thirrën një sipërmarrës. Prindërit ia shpjeguan që taveri pikonte, por ata s'e shpjegonin dot se si ndodhte. U bë një kërkim i imtë i burimit të dëmit.

S'u gjet asgjë. U ndërrua taveri. Bianka vazhdoi të rritej dhe njolla të reja uji u shfaqën, duke u krijuar përgjatë gjithë tavanit në dhomën e fëmijës natën harqe të thella. Pasi ndërruan taverin për herë të tretë, prindërit e saj hoqën dorë. Duhet të zgjidhnin mes bijës së tyre dhe ruajtjes së gjendjes mendore, shpëtimit të martesës.

Ata e çuan Biankën tek jetimorja në skaj të qytezës,



e lanë në shkallët prej betoni me një shënim të vendosur brenda trikos. Bianka qau për katër ditë me radhë pasi ata ikën. S'kishte njeri ta ngushëllonte. E vetmja foto që Bianka ruan si kujtim nga fëmijëria është ajo që i bënë murgeshat në ditën e saj të dytë në jetimore. Në fotografi, ajo është tri vjeçe. Motër Meri Anxhelika po e mban në krahë. Krahët e saj topolake zgjaten përpara, gishtërinjtë e veckël i ka mblodhur grusht. Faqet i ka të skuqura nga zemërimi, të zbutura nga lotët. Sytë dhe goja janë të kuqe, krejt të hapura.

Bianka ra dakord që të kishte një takim me Denin, i cili punonte në një firmë avokatie pak kate poshtë zyrës së saj, vetëm pasi ai nisi t'i linte çdo mëngjes shënime të shkruara me dorë mbi tryezën e saj. I shkruante gjëra të bukura, trillane. Kishte shumë dhunti në të shkruar. I tregoi për të gjitha gjërat që i pëlqenin tek ajo dhe e përdori atë fjalën "dashuri" pa qenë i akoma vetëdijshëm. Kur ajo më në fund i hapi udhë këmbënguljes së tij, ajo propozoi të takoheshin në një restorant të vogël jashtë. Ndërsa hëngrën duke i buzëqeshur njëri-tjetrit, re të zeza u mblodhën mbi tryezën e tyre. Ajo mund të ndjente pikat e shiut mbi shpatulla. Shumë afër saj, binin rrezet e diellit. "Është gjëja më e çuditshme që kam parë ndonjëherë," tha Deni. Aty nga fundi i vaktit, po ngacmonin njëri-tjetrin me këmbë. Ai kapi lehtë kyçet e gishtërinjve të saj dhe buzëqeshi, duke mos ia shqitur sytë. E pyeti nëse mund të shkonin në shtëpinë e saj për të pirë diçka pas darke, por pasi Bianka u zbeh në fytyrë, Deni i kërkoi ndjesë që ishte treguar kaq i drejtpërdrejtë. "Jo," tha Bianka. "S'është kjo arsyeja. Tek unë është një rrëmujë e vërtetë." Ndërsa po e çonte në shtëpi, kaluan ndanë një parku. Ajo e rroku në sup. "Hap krahun këtu." Deni i qeshi fytyra dhe iu drejtua parkingut të zbrazët. Bianka hoqi këpucët dhe ia dha vrapit nëpër barishten e paanë për tek rrotullamja për fëmijë.

Kishte pasur një kënd lojërash në jetimoren e saj. Luante shpesh atje, vetëm. Fëmijët e tjerë kishin frikë nga ajo, ashtu si shumica e murgeshave që përpqeshin ta donin si një nga bijtë e Perëndisë, por s'arrinin dot. Priftërinj që vinin nga larg silleshin që ta vizitonin, ta mirosnin me ujë të shenjtë. Të gjithë thonin të njëjtën gjë. Çfarëdo që ta kishte pushtuar shpirtin e saj, kjo ishte punë e djallit dhe e të keqes. Çfarëdo që e zotëronte ishte më e fuqishme se Perëndia e tyre. U mbajtën mesha për të, për këtë fëmijë që ndiqej ngado nga uji dhe rrënim. Bianka megjithatë ia doli të rritej si fëmijë i lumtur. Ajo kapej pas njëres prej kangjellave të hekurit në rrotullame dhe vraponte sa më shpejt të mundej. Vraponte derisa toka lëvizte bashkë me të dhe era të fillonte të mblidhte retë. Ndërsa fillonin të binin pikat e para të shiut, ajo kërcente në rrotullame për të shkuar më pas në mesin e saj. Ulej aty në shpinë me krahët poshtë kokës, me fytyrën drejt nga qielli i lagësht.

"Ka vite që s'kam qenë në një rrotullame të tillë," tha Bianka, ndërsa ecte ngadalë, me marifet, duke prekur secilën prej kangjellave.

Me kujdes, u ngjit në qendër. Deni nisi ta rrotullonte gjithnjë e më shumë. Ajo mbylli sytë, duke u bërë njësh me fladin e ftohtë të natës. Kur krahët nisën t'i dhembnin nga lodhja, Deni e ndali rrotullimin dhe u ngjit në platformën e metaltë, ngadalë. Ai u ul në gjunjë mes kofshëve të Biankës dhe ajo filloi t'i shkopsiste këmbët. Kur të dy ishin lakuriq, Bianka u shtri në shpinë, duke shijuar ndjesinë e hulisave të metalit në lëkurën e saj. Deni i puthi ballin, qerpikët dhe buzët. Ai kishte shijën e verës dhe kripës me një aromë të këndshme. Ai u mahnit nga lagështia e lëkurës dhe lëpiu pikat e ujit në qafën e saj të hollë. Pastaj depërtoi brenda saj, duke qenë i pari mashkull në jetën e saj, gojën e kishte rrzë veshit, duke i pëshpëritur fjalë të nxehta që i kishte shkruar në letra. Për të parën herë i tha se e donte. Edhe ajo i tha të njëjtën gjë. Një shi i ngrohtë filloi të bjerë mbi trupat e tyre lakuriq. Deni ia mbajti fytyrën në duar Biankës, duke hequr mënjanë butësisht fjetet e gjata të flokëve. Ndërsa ajo kishte ngulur vështrimin në sytë e tij, kur trupi iu dorëzua plotësisht, ajo kishte shpresë.

Përkthyer nga *Granit Zela*

Marrë nga libri "Gra të vështira", Minerva, 2017



PEIZAZHI – RRËFIMTARI I RREZIKUAR

nga Virion Graçi

Njëri nga romanet më të mirë të nobelistit japonez Jasunari Kavabata “Vendi i dëborës” më jep dorë të kujtoj peizazhin si një rrëfimtari të padukshëm por fuqiplotë në kryeveprat e narrativës letrare. Episodi me të cilin fillon romani jep heroin kryesor duke udhëtuar me tren drejt vendit me dëborë ku do të kalojë ca kohë me një vajzë të bukur, një lidhje e përkohshme me fund tragjik, vajza digjet e gjallë në një sallë teatri të përfshirë aksidentalisht mes flakësh. Nga dritarja e trenit protagonist shikon diellin për një kohë të gjatë dhe herë mbas here: duket i kuq, si i përgjakur, si lëmsh orguzi që ka mbetur palëvizshëm në qiell. Episodi i fundit i romanit jep përsëri protagonistin duke parë në ikje e sipër djegien e ndërtesës së teatrit që ndodhet majë një kodre në lartësi mbizotëruese, thuhet atje lart në qiell sipas këndshikimit të personazhit. Atje, në atë majë kodre të pëflakur ndodhet dhe e dashura e tij, njëra nga bukuroshet e fjetura. Ndërtesa e teatrit, përfshirë plotësisht në vorbullën e flakëve, parë me sytë e heroit që dikur shikonte diellin duke udhëtuar me tren për të vendi i ëndërruar, përshkruhet identikisht i njëjtë si dielli i asaj dite të parë të udhëtimit: i kuq, i përgjakur, lëmsh orguzi i mbetur palëvizshëm në qiell. Mbetesh i çmeritur nga ky përkim i qëllimtë autorial. Madje duke dyshuar te “tradhëtia” e mundshme e përkthyesit shqiptar nga rusishtja e pashë tekstin në një gjuhë tjetër; gjeta të njëjtën simetri midis fillimit të romanit dhe fundit të tij. Po kështu ndodh në dy romane të tjerë të këtij mjeshtri: “Liqeni” dhe “Zhurma e malit”. Pas leximit të romaneve më ra rasti të lexoj fjalën e tij në ceremoninë e marrjes së çmimit Nobel. “Bora, hëna, lulëzimi pranveror, fjalët shprehëse të stinëve ashtu si ato lëvizin nga njëra te tjetra, përfshirë në traditën e bukur japoneze bukuri malesh, lumenjsh, bari dhe pemësh, në mijëra manifestime të natyrës janë po aq të bukura sa ndjenjat njerëzore.” Ndërsa në vlerësimet e ndryshme për Kavabatën njëri mbetet i palëvizshëm:

me pamje e lëvizje të natyrës, të florës e të faunës, të tingujve dhe të ngjyrave të peizazhit Kavabata arrin të japë gjendje të komplikua shpirtërore të njeriut, të bashkojë të brendshmen me botën e jashtme.

Mjeshtri tjetër i narrativës letrare në shek. XX, Hemingueji i njohur për teorinë e nëntekstit, për parimin e ajsbergut dhe për tregimet e papërfunduara skematikisht por të hapur për bashkëkrijim kuptimor e emocional me lexuesit, gjenerues kuptimesh e simbolikash alternative, porosiste me këmbëngulje një letrar të ri: mos harro pa treguar saktësisht në çfarë ambienti zhillohen ngjarjet, jep hollësisht peizazhin dhe përshkruaj në çdo etapë motin, kohën, ndryshimin e saj. Falë kësaj porosie serioze dhe këmbëngulëse mjeshtri Heminguej është quajtur jo me ironi por në mënyrë përgëzuese edhe si një nga përfaqësuesit e mëdhej të realizmit meteorologjik. Kryevepra e tij “Plaku dhe deti” është një nga shembujt më tipikë ku peizazhi natyror, i jashtëm ndërvepron me botën e brendëshme të personazhit, flet në emër të tij, e përfaqëson gjendjen e tij stoike dhe dramatike pa fjalë, vetëm me ngjyra, nuanca ngjyrash. Duket se mjeshtri rrëfimtari vetëm sa ka pikturuar një plak dhe detin, romanin në shumësinë e kuptimeve të tij simbolike, alegorike e filozofike e krijojmë ne, bashkautorët, lexuesit e tij.


Në shek. XX duket se peizazhi e ka humbur rolin dhe misionin vendimtar që ka pasur për realistët e një shekulli më parë. Balzaku quhet i lexuar në galerinë e personazheve të tij për aq sa arrijmë të njohim vizualisht prej përshkrimeve të tij të hollësishtë vendin ku do të zhvillohet ngjarja — pra peizazhi paralajmëron, përgatit dhe sjell në jetë personazhin. Po kështu te romantikët personazh kryesor është peizazhi, ai jep tonalitetin rrëfimit, ai jep nuancat ideore dhe emocionale, ai siguron unitetin kuptimor dhe emocional të krejt veprës. Të njëjtin kult të

natyrës e peizazheve të saj, ndonëse me natyrë obscure gjejmë te pararomatikët, sentimentalistët e errët si Ana Radklif, Lorenc Stern, etj. Edhe novelistika satirike iluministe e Volterit, krejt në funksion të ideve dhe pikëpamjeve që do të përcjellë e ilustrojë autori i lë vend të admirueshëm natyrës, peizazhit.

Fillimi i shek XX, me mbylljen e ciklit krijues të realistëve të mëdhej rusë: Tolstoi, Turgenjev, Gogol, Cehov, Dostojevski, me mbylljen e etapës romantike të krijimtarisë të Gorki duket se shënon fundin e peizazhit si sipërmarrës në rrëfimet e mëdha romanore. Kështu, tek shkruan romanin autobiografik “Njeriu i parë,” ngelur dorëshkrim për shkak të vdekjes aksidentale, Albert Kamy në shënimet paraprake shkruan se me atë roman do t’i kthejë vetes të vërtetat burimore familjare kurse prozës së gjatë, romanit si gjini letrare do t’i kthejë në mënyrë pajtuese atë që i mungon prej disa dhjetëvjeçarësh: natyrën e plotë, peizazhin. Dhe ashtu bën. Autori i “Murtajës”, “Rënies”, “I huaji”, aq të njohura edhe për distancën diferencuese prej tablove natyrore, te romani “Njeriu i parë” që aksidenti tragjik e la të ishte i fundit, testamental, iu kthehet fuqishëm përshkrimeve poetike të natyrës.

Te antiromani francez, duke u vënë në diskutim serioz të tërë arritjet e narrativës romanore në nivel tradite: fabula bazë, personazhet, ligjërimi, dialogimi i zakonshëm, përshkrimi i jashtëm i personazheve, natyra çuditërisht bëhet protagonist, hero kryesor, krej historia romanore është vendi i veprimit, pra peizazhi përpiqet të zvendësojë krejtësisht ngjarjen romanore duke lënë në role sekondare personat veprues, njerëzit. Tropizmat e Sarrotit janë më tipikët në këtë revansh të mjedisit veprues ndaj personave veprues.

I quajtura realizëm magjik i Amerikës Latine, me Kortazar, Fuentes, Gabriel Garsia-Markez e Vargas-Llosa, (Borges nuk i jepet peizazhit) megjithë heronjtë e jashtëzakonshëm, shpesh eksentrikë dhe egzotikë



Jasunari Kavabata



Ernest Hemingway



Albert Camus



G. G. Márquez

njëkohësisht i jep natyrës, peizazhit dhe ambientit rol përcaktues. Madje, të tilla historira magjike, përrallore, të pabesueshme për europianët janë krejt të zakonshme, realiste, të natyrshme për lexuesit dhe autorët e tyre që ndajnë me protagonistët e romaneve të njëjtin kontinent, të njëjtat vende, të njëjtat qytete, fshatra, krahina, pra banorë e dëshmitarë autentikë të të njëjtit kontinent magjik, që për ata vetë është i zakonshëm, krejtësisht i zakonshëm.

Në letërsinë shqipe të shek XX, peizazhi aq i përdorur nga romantikët, gjen hapësirë për të luajtur rol në narrativat e shkurtëra të Koliqit dhe Migjenit (peizazhe idilizuese dhe simbolike të i pari, dhe ilustruese, përforcuese tematike e kuptimore, pra si *bukuri që vret*, të i dyti) për të gjetur pastaj një rilindje të gjithanshme, të pakrahasueshme me Lasgushin dhe Kutelin. Këta, njëjloj si De Rada e afrojnë poezinë me pikturën, si pak kush tjetër. Por, para tyre Mjeda e ka ngritur peizazhin në pikën më të lartë funksionale dhe estetike. Nga letërsia shqipe pas luftës së dytë botërore deri në vitin 90-të doja të theksoja faktin se përdorimi i peizazhit u reduktua kanonikisht në klishtë e pllakatit skematik: -pranvera, dielli, mallet, pyjet e gjelbëruar, qytetet e reja të minatorëve, piramidat kufitare, fortifikatat e reja dhe kështjellat mesjetare, kantieret, oxhakët e fabrikave dhe kombineve industriale ishin pjesë e padiskutueshme e të njëjtës simbolikë ilustrative, pasqyrë e atdheut socialist, e progresit të tij të pandalshëm, sikurse në krahun tjetër të frontit revolucionar komunist, me të njëjtën disiplinë dogmatike mbizotëronte skematikisht peizazhi i stërpërdorur i errësirës, i prapambetjes, i sabotazhit, i reaksionit, i armiqve të partisë-shtet e pushtetit totalitar komunist. Gjenden sigurisht fragmente të spikatura të peizazhit të tregimtarë të njohur si V. Koreshi, F. Ballanca, K. Kosta, Z. Çela, N. Lera si dhe te poetët të sprovuar si D. Agolli, F. Arapi, M. Camaj. Në këtë radhë do të shtonim poetin Frederik Rreshpja poezia e të cilit, sipas meje përsërit cilësisht poezinë e De Radës, Mjedës dhe të Lasgushit njëkohësisht: pikturë, natyrë e shpirtëzuar, simbolikë dhe melankoli. Kurse nga romancierët është I. Kadare ai që i beson role të rëndësishme narrative peizazhit, në disa nga romanet e tij më të njohur duke nisur me *Gjeneralin*, *Kështjellën*, *Breznitë* e *Hankonatëve* e deri në krijimet më të vona. Në strukturat kompozicionale unazore I. Kadare, i nis dhe i përfundon historitë e tij romaneve me të njëjtat pamje, shpesh krahasuese përsa u përket elementëve meteorologjikë të natyrës si shiu, era, vranësinat, ose pamjet e thjeshta qytetëse. Ballafaqimi i pamjeve të njëjta natyrore pas përplasjeve të fuqishme klasore, sociale, politike dhe shpesh dhe konflikte të aratosura ushtarake si te *Kështjella*, për shembull ka qënë zakonisht në theksim të idesë se jeta

e zakonshme njerëzore përsëri do të mbijetojë duke iu rikthyer ritmit të saj të përditshëm. Kështu ndodh te *Kronika*, te *Dimri i madh*, te *Koncerti*, te *Kështjella*. Në secilin rast te Kadare gjetjet dhe zgjidhjet përmes gjuhës së peizazhit janë të shkëlqyera, funksionale dhe origjinale njëkohësisht. Po kështu, Koço Kosta me përmbledhjen me tregime *Pasdite me shi* dhe sidomos me romanin *Nata e Sofie Kondilit*, dëshmon mjeshtëri të rrallë në përdorimin funksional të peizazhit si zë i pazvendësueshëm rrëfimtari.

Në letërsinë shqipe të njëzet viteve të fundit, peizazhi në veçanti dhe natyra përgjithësisht, janë protagonist të lënë padrejtësisht jashtë lojës artistike. Përfashtime pozitive përbëjnë në këtë mes *Mërkuna e zezë* e Agron Tufës dhe *Varrezat e vendlindjes* e Romeo Collakut. Mërkuna mbipullohet me peizazhe të malsisë së mbuluar me dëborë, dritë mbi dëborë, errësirë mbi tokën e shtruar me dëborë, etj. Varrezat kanë is protagonist të zakonshëm dy vjedhësa varresh por peshën kuptimore dhe emocionale të veprës e luan peizazhi i animizuar, ai është protagonist i padiskutueshëm dhe bërthama dramatike e groteske e ndodhisë romaneve. *Gjarpëri i shtëpisë* i Arian Lekës, megjithëse të çon pikërisht në atdheun e muzave të peizazhit, në burimin e tyre në bregdet, përsëri nuk na jep nga ai ujë i bekuar: rrëfimi romanor ndjek linjën e dialogimeve të ngarkuar me nëntekst e simbolikë duke i gërshetuar ato me monologë të brendshëm-shprehje autentike e një vetëdijeje të mbingarkuar



Jean-Marie G. Le Clézio

psikologjikisht dhe emocionalisht. "Gjumë mbi borë" i R. Dibrës, arritja më e mirë e tij e deri sotëshme në fushën e romanit, e bën peizazhin dimëror të veriut parësor...

E lashë për në fund arritjen më të mirë të peizazhit-rrëfimtari në fondin e artë të krejt trashëgimisë botërore: është fjala për "Komedinë hyjnore" të Dante Alighierit. Pas çdo rileximi e përfytyroj këtë kryevepër si ekspozitën më të pasur dhe më imponuese të pikturës në botë, e kujtoj si galerinë më të pasur të artit piktural arritur me mjete të rrëfimit poetik, përmes peizazhit. Në fillim propozohen si piktura pamjet e çuditshme për udhëtarin Dante gjithë sa i parashtrihen viset e njerëzit e panjohur në atë udhëtim nga ferri në parajsë. Mandej, si u shkon afër, pas shpjegimeve të udhëheqësit të tij Virgjilit (në ferr dhe purgator) dhe Beatrices (në parajsë) bota e turbullt, sipërfaqësore e pikturale shndërrohet në botë tre dimensionale, në ansambël skulpturor, sintezë fatlume e botës frymore me atë materiale. Është e vetmja vepër letrare që është vetiu e ilustruar nëpërmjet ligjërimit poetik nga tablot masive deri te imtësitë më domethënëse prej vet autorit poet, pa pasur nevojë për piktor të mirëfilltë, për lapsa, ngjyra dhe mjete të zakonshme të pikturës së rëndomtë.



Orhan Pamuk

Dy nga romancierët nobelistë të viteve të fundit: O. Pamuk dhe Le Clezio i japin vend protagonist peizazhit. "Bora" e Pamukut, roman epik, me intrigë policeske, me tone polemiste e interpretime politike njësohet si lëndë artistike te imazhi bazë i borës si lejtmotiv dhe dekor i pandryshueshëm. Bora i forcon pathosin lirik rrëfimit dhe i ndërlihd personazhet me vendin e ndodhisë romaneve. Le Clezio në vlerësimet që jep për vendet e Botës së Tretë, duke argumentuar adhurimin e tij për natyrën dhe kulturën e tyre thotë: atje lumi shihet vetëm si lumë, ka vetëm kuptimin dhe domethëniet e lumit; pema është vetëm pemë e asgjë tjetër, çdo gjë shikohet e vlerësohet ashtu si duket pa iu nënshtruar shfrytëzimeve e tjetërsimeve kuptimore.

Për sa parapamë deri këtu shprehin një shije vetjake timen si lexues më tepër se një ligjësi të nënkuptuar për marrëdhëniet e peizazhit me narrativën artistike në përgjithësi. Po ashtu shembujt e gjetur janë vetëm disa ndër mijëra vepra të botës së madhe letrare ku, sidoqoftë, prania në shkallë të ndryshme ose jo e peizazhit nuk lidhet aspak me klasifikimin a kualifikimin cilësor të vet veprës. Mbetem i mendimit se peizazhi natyror, i mirëqenë, i mirëpërshkruar, i padiskutueshëm në vetvete provokon ndjeshmëri, mendim, simbolikë, alegori po aq, e ndoshta - edhe më tepër se secila gjetje e situatë ndërnyerëzore, sociale. Po ashtu, pamja natyrore e objektivizuar në funksione të qarta ideo-artistike është edhe më realiste dhe shprehëse se secila zgjidhje tjetër, është, këmbëngul unë, një rrëfimtari i besueshëm, tërheqës dhe lakonik.



Portreti i Virion Graçit dhe Ismail Kadare nga Ina Lajthia

ASHAK: Çmimi Nobel iu dha një mbështetësi të Milosheviqit

nga MEHMET KRAJA

Prishtinë, 10 tetor 2019

Akademisë Suedeze, Stokholm

Në dijeni: Jurisë për ndarjen e Çmimit Nobel për
Letërsi

Të nderuar titullarë dhe anëtarë të Akademisë,
Me indinjatë të thellë morëm lajmin e
shëmtuar se laureat i Çmimit Nobel për Letërsi
për vitin 2019 është shkrimtari Peter Handke, një
eksponent i shquar i ideve fashiste të nënshtimit
dhe robërimit të popujve dhe mbështetës i
pasionuar i Milosheviqit dhe i luftërave të tij
gjenocidale në Ballkan, përfshirë edhe Kosovën.
Si Akademi e një shteti të sapo krijuar mbi vlerat
perëndimore të lirisë së popujve dhe institucion që
edhe vetë ka vuajtur segregacionin dhe aparthejdin
e një regjimi të urryer dhe luftën e tij shfarosëse,
nuk kemi besuar se kaq shpejt do të përballemi me
humbjen e kujtesës dhe amnistinë morale të atyre
që mbështeten me aq pasion një vrasës të popujve,
siç bëri laureati i juaj, Peter Handke. Mospajtimi
i thellë me angazhimet politike dhe deklaratimet
publike të Handkes, bashkë me mbështetjen e
pakursyer të mbarë botës progresive, përfshirë
edhe Suedinë, bëri që sot popull ynë të njohë lirinë
dhe jetën e dinjitetshme.

Peter Handke nuk ishte në anën e drejtë të
historisë së popujve të Ballkanit dhe as të Kosovës;
nuk ishte në anën e ndritshme të ideve, por gjeti
strehë në anën e errët të ngjarjeve tragjike të
Ballkanit. Si rrallë ndokush tjetër, ai mori pjesë
në varrimin e Milosheviqit dhe deklaroi: “Nuk e
di të vërtetën. Por unë shoh. Unë ndjej. Unë mbaj
mend. Andaj jam këtu sot, pranë Jugosllavisë,
pranë Serbisë dhe pranë Slobodan Milosheviqit.”
Më herët, në maj të vitit 1999, ai u deklarua
kundër bombardimeve të NATO-s, duke thënë se
Aleanca Veriatlantike nuk është duke parandaluar
Aushvicin e ri, por është duke e krijuar atë. Ai
sulmoi pa dallim të gjithë ata që mbështetën
ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë, qofshin
politikanë apo dijetarë të shquar të mbarë botës.
Ende sot trazojnë Ballkanin aq shumë viktime pa
varre, të cilat kërkojnë prehje dhe drejtësi.

Ideja se angazhimet dhe bindjet politike duhet
ndarë nga vepra e një shkrimtari, nuk funksionon
në rastin e Peter Handkes. Përkundrazi, idetë e
tij agresive u afishuan aq shumë, teksa synonin të
luhatnin fondamentin e vlerave të civilizimit dhe
humanitetit.

Të zhgënjyer thellësisht me ndarjen e sivjetshme
të Çmimit Nobel, Akademia e Shkencave dhe
Arteve e Kosovës kërkon të anulohet ky vendim
i Akademisë Suedeze, si akt mirëkuptimi e
solidariteti me të gjithë popujt e botës që luftojnë
për liri dhe vlera demokratike.

Me respekt,
Mehmet Kraja,
Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të
Arteve të Kosovës

Dramaturgu, romancieri dhe poeti austriak, Peter Handke i
cili është në moshën 76 vjeçare, u vlerësua për “një vepër
me influencë, që me origjinalitetin gjuhësor ka eksploruar
kufijtë dhe specifikat e përvojës njerëzore”, u shpreh
akademia në një deklaratë.




Salman Rushdie, në një artikull për
gazetën The Guardian në vitin 1999, e
cilësoi Handke-n “idiotin e vitit”, për
“apologjitë e tij të sinqerta për regjimin
gjenocidal të Slobodan Milosevic-it”.

Kur Handke shkoi në Norvegji për të
marrë Çmimin Ndërkombëtar Ibsen
në vitin 2014, u prit nga protestues
që i thërrisnin “fashist” e që mbanin

pankarta me fjalët “mohues i gjenocidit”

Por ai është një person i drejtpërdrejtë
dhe disa prej komenteve të tij kanë
qenë fyes. Njëherë ai mohoi masakrën
serbe në Srebrenicë, dhe e krahasoi
fatin e serbëve me atë të çifutëve gjatë
Holokaustit, megjithëse më vonë ai
kërkoi falje që i “rreshqiti goja”.



Ndërsa shkrimtarja Tokarczuk, 57
vjeçe, e cila konsiderohet si romancierja
më e mirë polake e brezit të saj, e mori
çmimin “për imagjinatën narrative, e
cila me pasionin gjithëpërfshirës paraqet
kapërcimin e kufijve si një formë të jetës”.

Librat e shkrimtares polake shiten
shumë, dhe përziejnë të vërtetën me
mistikën.

Romani i saj i parë u botua në vitin
1993, dhe famën e mori tre vite më pas
me romanin *Primeval and Other Times*,
i cili gjurmon historinë e Polonisë nga
Lufta e Parë Botërore e deri në vitet '80.

“Ajo është një shkrimtare që merret
me jetën lokale, por që njëkohësisht
frymëzohet nga hartat dhe mendimet
spekulative, dhe e sheh jetën nga sipër”,
u shpreh juria.

Vepra e saj “përqendrohet te migracioni
dhe tranzicionet kulturore, si dhe është e
mprehtë dhe e arrirë”, shtuan ata.

DRITA DHE ERRËSIRA E ÇMIMIT NOBEL 2019

nga Rafia Zakaria (CNN)

“Ju e dini se ishim ne që ju mbrojtëm për shekuj me radhë nga hordhitë aziatike. Dhe pa ne do të hanit ende me duar”. Kështu deklaroi një personazh që mbron serbët (dhe masakrat e tyre) në dramën e luftës së shkrimtarit Peter Handke, “Voyage by Dugout”. Megjithatë këto janë fjalët e një personazhi, krijuesi i tij, Handke, bëri bujë kur foli në funeralin e vitit 2006 të diktatorit dhe kriminelit serb të luftës, Slobodan Milosevic, dhe tashmë i është dhënë Çmimi Nobel 2019 për Letërsinë, duke shqetësuar shumë njerëz.

Ai nuk është i vetmi fitues. Këtë çmim e ndan me autoren polake, Olga Tokarczuk, e cila mori çmimin për vitin 2018, dhe vitin e kaluar ishte fituese edhe e Çmimit Man Booker. Vepra e Tokarczuk-ut, e cila ka fituar plot çmime të tjera (si Nike, çmimi më i lartë në letërsi që jep shteti i Polonisë) përqendrohet në sfidimin e mbulesave nacionaliste për tiranitë historike. Të dy çmimet u dhanë njëkohësisht, pasi Nobeli në letërsi për vitin 2018, u shty pas një skandali seksual dhe financiar.

Vepra e të dy shkrimtarëve është një studim kontrastesh, duke përshkruar përçarjet që përndjekin Europën në këto ditë grindjesh ideologjike midis nacionalistëve të ekstremit të djathtë, neo-nazistëve, antifashistëve dhe kozmopolitëve, pjesërisht nëse të gjitha bindjet morale janë vërtet të barabarta dhe gati njësoj të lavdërueshme. Përhapja “e të dy palëve” me të cilën amerikanët fatkeqësisht janë mësuar kaq shumë prej politikës së presidentit të tyre, tani duket se ka infektuar edhe Komitetin e Çmimit Nobel për Letërsinë. Duke ofruar versionin e “të dy palëve” për Çmimin, mesa duket, anëtarët e zgjedhur përjetë, kanë refuzuar të bëjnë gjykimin moral që kërkon letërsia e mirë.

Vepra e Tokarczuk-ut është një pranim i ndërtimit të urës letrare dhe e eksplorimit të kufijve. Ajo ka qenë një psikologe, dhe romani i saj i vitit 2014, “Librat e Jakobit”, zhvillohet në kufirin polako-ukrainas dhe tregon për një udhëheqës fetar hebre të shekullit të 18-të, i cili detyroi hebrenjtë të ktheheshin në katolikë. Në stilin karakteristik të Tokarczuk-ut, ky roman trajton imazhin e polakëve për veten e tyre, si vendi i shtypur moralisht i Europës, duke theksuar ato që Tokarczuk ka përshkruar në një intervistë televizive si “akte të tmerrshme” kolonizimi, të cilat ata i kryenin vetë. Për këtë akt të egër të letërsisë, i cili shkonte kundër narracionit nationalist të historisë polake, Tokarczuk u shpall menjëherë një tradhtar nga shumë njerëz të së djathtës ekstreme polake. Pastaj filluan kërcënimet me vdekje, të cilat e bënë botuesin e saj polak të punësonte truproja për të.

Projekti politik i Handke-s në veprën e tij

letrare është më i lig, duke ia kushtuar mjeshtërinë e tij errësimit të kategorive morale në atë që një komentues gjerman në vitin 2006 e quajti “një relativizim lozonjar” të përfshirjes morale të serbëve në masakrën e drejtuar nga Milloshevic-i ku humbën jetën gati 200,000 njerëz në Bosnjë. Guximi i tij i solli mbështetje Handke-s në radhët e elitës letrare serbe, dhe censurim nga pothuajse kushdo tjetër (mendimtarja amerikane Susan Sontag, e deklaroi atë “të mbaruar” në New York pasi u vu në skenë “Udhëtimi nga Dugout”).

Nga ana e tij, Handke e mbrojti veten në një intervistë në 2006 duke thënë se Milloshevic-i “nuk ishte një hero dhe n j ë qenie



njerëzore tragjike”, dhe se ai “ishte shkrimtar e jo gjykatës”. Ishte lloji i deklaratës dredharake që mund të bëjë një njeri me talentin e tij të jashtëzakonshëm letrar. Edhe nëse dikush do ta pranonte hipotezën e tij se shkrimtarët nuk kanë kontroll mbi kornizat morale në të cilat vendosin krijimet e tyre imagjinare, kjo nuk e eliminon faktin se kur aleatët perëndimorë filluan bombardimet për të ndaluar masakrën që po vazhdonte, ai shkroi një letër të hapur ku me zemërim i dënonte si “kasapë që falen në altarët e perëndive të luftës”.

Midis të dyve, Tokarczuk është më e preferuar për çmimet letrare, ndërsa Handke është famëkeq për faktin se çmimet që ka fituar (siç ai Heinrich-Heine), i janë tërhequr mbrapsht. Qëndrimi i tij i lartë ndaj gjërave të tilla është i dukshëm; ai iu përgjigj humbjes së Heinrich-Heine duke thënë se

kishte ndërmend ta refuzonte këtë çmim.

Ndoshta në mënyrë jo të habitshme, edhe pse është ironike tani, Handke në vitin 2014 kërkoi publikisht që Çmimi Nobel për Letërsinë të hiqet për “kanonizim të rremë të letërsisë” dhe dënoi dhënien e tij të rëndomtë si “një moment vëmendjeje dhe gjashtë faqe në gazetë”.

Mund të përfytyrohet se Handke ndihet ndryshe tani që është kurorëzuar mbret, se ndoshta me gjeninë e tij, po shfaqëson politikën e tij keqdashëse, të paktën në sytë e Komitetit të Çmimit Nobel. Mungesa e lidhjes së njëres me tjetrën mund të jetë vërtet racionalizimi i Komitetit të Nobelit që i dha Handkes këtë çmim, por kjo mendësi nuk e mbulon erën e keqe të nderimit të një njeriu i cili ka mbështetur një kriminel lufte me një eulogji. Për të mbrojtur përzgjedhjen e tyre, Mats Malm, sekretari i përhershëm, tha që komiteti zgjodhi mbi bazën letrare dhe estetike dhe se “nuk është në autoritetin e akademisë që të balancojë cilësinë letrare kundrejt konsideratave politike”.

Faji i akademisë nuk është te limitet e autoritetit të tyre, por te refuzimi i dukshëm për të marrë parasysh faktin se cilësia letrare në vetvete është e lidhur në thelb me konsideratat morale. Është e vërtetë se Komiteti i Nobelit zgjodhi të nderonte një grua këtë vit, ajo që është quajtur “autorja e gjallë më e mirë për të cilën nuk keni dëgjuar kurrë”. Gjithsesi gati duket sikur ata nuk mund ta duronin të nderonin vetëm Tokarczukun, gruan e pesëmbëdhjetë me fat, kundrejt 113 burrave që kanë fituar Çmimin Nobel.

Puna e Handkes përfaqëson kaq mirë krahun e djathtë të ndarjes politike në Europë, atë që kërkon të rigjallërojë një të shkuar të imagjinuar dhe e percepton të tashmen si një moment viktimizimi duke shkelur të tjerët, gratë, minoritetet dhe veçanërisht emigrantët acarues. Puna e Tokarczukut është një rebelim kundër këtij nacionalizmi kufijsh; libri i saj i vitit 2007, “Fluturimet”, botuar në anglisht në vitin 2017, pasqyron jetët nomade të njerëzve që jetojnë në të tashmen. Zgjedhja e saj nga juria e përhershme e Nobelit duket si një anim kundrejt të majtës që sheh përpara.

Në refuzimin për të zgjedhur midis Handke dhe Tokarczukut, komiteti u dha të dyve barazi morale të pamërituar. Është një hile nga libri i lojërave të Handkes – 200,000 njerëzit që u vranë në duart e diktatorit serb Slobodan Miloshevic mes viteve 1993-1996, ishin viktimat e një lufte të cilën në 2006 Handke e konsideroi si “të tmerrshme nga të gjitha anët”. Edhe pse të gjithë shkrimtarët kanë të drejtë të thonë atë që duan, ajo çfarë ata thonë ka një lidhje të madhe me respektin që u jepet.

Përktheu David Hudhri

Autorja bestseller #1 e "New York Times" e "Vajza, Iani fytyrën"

RACHEL HOLLIS

VAJZA, MJAFT
ME SHFAJËSIME

NJË PLAN PA NDROJE PËR TË PËRQAFUAR DHE ARRITUR SYNIMET TUAJA

Minerva